



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT  
DEPARTAMENTI I HIDROTEKNIKËS DHE HIDRAULIKËS

# DISERTACION

PËR MARRJEN E GRADËS “DOKTOR”  
NË SHKENCAT INXHINIERIKE

TEMA

**“Vleresimi I Normave Te Ujitjes Sipas Standarteve Europiane Ne Shqiperi”**

Kandidati  
MSc. Andrin KËRPAÇI

Udhëheqës Shkencor  
Prof. Agim SELENICA

Tiranë, Dhjetor 2021

## Përmbledhje

Shqipëria është një vënd ku rreth 50% të punësimit e zë bujqësia dhe si e tillë, ajo ka nevojë që resurset që ka për të zhvilluar këtë sektor ti shfrytëzojë në mënyrë sa më optimale.

Në total, toka bujqësore zë një sipërfaqe prej 695 000 ha ( 24% të sipërfaqes totale të vendit ) , nga të cilat rreth 360 000 ha vlerësohet që mund të ujitet, dhe rreth 120 000 ha janë potencialisht të ujitshme .

Për të bërë një administrim sa më të mirë të burimeve ujore në funksion të zhvillimit të bujqësisë, duhet në rradhë të parë që të përcaktohet sa më mirë dhe sasia e ujit që duhet për ujitje, kjo pasi dhe llojet dhe numri i bimmëve që mbillen tani, ndryshojnë me ato që janë mbjellur përpara viteve 90 .

Në këtë punim do të përcaktohen nevojat për ujë për bimë të ndryshme duke u nisur nga metodika e rekomanduar nga Organizata Botërore e Ushqimit ( FAO ), FAO Penman-Monteith e e publikuar FAO Irrigation and Drainage Paper No. 56 ( FAO – 56 ) , si një standart i ri për të llogaritur Evapotranspirimin potencial për bimë të ndryshme .

Ky punim ka si qëllim që të hatojë hartat e Shqipërisë për:

- Evapotranspiracionin referues ( ETo ), në bazë mujore dhe atë vjetore.
- Shiun efektiv me 75 dhe 90 % siguri në bazë mujore dhe vjetore.
- Evapotranspirimin për bimë të ndryshme për të gjithë kohën e vegjetacionit.
- Normat e ujitjes për shiun efektiv me 75 dhe 90 % siguri për të gjithë kohën e vegjetacionit.

Ky material mund të shërbejë në të ardhmen si nje udhëzes për të llogaritur normat e ujitjes për bimë të ndryshme që nuk janë të përfshira në këtë punim, por mund të shërbejë dhe për planifikimin dhe projektimin e veprave të ndryshme ujitëse .

**Fjalë kyqe:** Meterologji, Hidrologji, Bimë, Evapotranspirim, Norma e Ujitjes

## Abstract

Albania is a country where about 50% of employment is occupied by agriculture and for this, she needs that all the resources it has to develop this sector in the most optimal way.

In total, agricultural land occupies an area of 695 000 ha (24% of the total land area), of which about 360 000 ha are estimated to be irrigable, and about 120 000 ha are potentially irrigable.

In order to make a better management of water resources for the purpose of agricultural development, it necessary to determine the amount of water needed for irrigation, as well as the types and number of plants that are planted now. differ from those planted before the 90s.

This study will determine the water needs for different crops based on the methodology recommended by the World Food Organization (FAO), FAO Penman-Monteith and published by FAO Irrigation and Drainage Paper No. 56 (FAO - 56), as a new standard for calculating Evapotranspiration for various plants.

This study aims to produce maps of Albania for:

- Reference evapotranspiration (ET<sub>o</sub>), on a monthly and annual basis.
- Effective rain with 75 and 90% probability on a monthly and annual basis.
- Evapotranspiration for different crops for the entire vegetation period.
- Irrigation rates for effective rain with 75 and 90% probability for the entire vegetation time.

This material can serve in the future as a guide to calculate irrigation rates for different plants that are not included in this study, but can also be used for planning and designing various irrigation works.

**Keywords:** Meteorology, Hydrology, Crop, Evapotranspiration, Irrigation rate

1. Përmbajtja	
<b>2. Hyrje</b> .....	<b>7</b>
<b>3. Qëllimi i studimit</b> .....	<b>7</b>
<b>4. Të përgjithshme</b> .....	<b>8</b>
4.1 Procesi I Evapotranspirimit .....	8
4.2 Avullimi.....	8
4.3 Transpirimi .....	9
4.4 Evapotranspirimi .....	9
<b>5. Faktorët që ndikojnë në evapotranspirimi</b> .....	<b>10</b>
5.1 Parametrat e motit.....	10
5.2 Lloji i bimës.....	10
5.3 Kushtet e menaxhimit dhe mjedisit .....	10
<b>6. Kulturat bujqesore dhe probleme te tjera te agroteknikes deri ne vitet 90</b> .....	<b>12</b>
6.1 Vështrim mbi normat egzistuese të ujitjes në vëndin tonë.....	12
<b>7. Metodat dhe të dhënat e përdorura për vlerësimin e normave të ujitjes</b> .....	<b>17</b>
7.1 Metoda Blaney – Criddle.....	17
7.2 Metoda Thornthwaite .....	17
7.3 Metoda Quijano .....	18
<b>8. Të dhënat meteorologjike</b> .....	<b>20</b>
<b>9. Metoda e përdorur për përcaktimin e normave të ujitjes</b> .....	<b>25</b>
9.1 Ekuacioni Penman-Monteith .....	25
9.2 Presioni atmosferik .....	29
9.3 Konstantja psikrometrike.....	29
9.4 Presioni messatar i ngopjes së avujve ( es ).....	30
9.5 Rrezatimi neto ( Rn ) .....	31
9.6 Shpejtësia e erës.....	31
9.7 Evotranspirimi i bimës ( Etc ).....	31
<b>9.7.1 Mënyra me një koeficientit të vetëm të bimës (Kc)</b> .....	<b>33</b>
<b>9.7.2 Mënyra e koeficientit të dyfishtë të kulturave (Kcb + Ke)</b> .....	<b>34</b>
<b>9.7.3 Kurba e koeficientit të bimës</b> .....	<b>34</b>
<b>9.7.4 Rregullimi i koeficientit <math>K_{c\ ini}</math></b> .....	<b>37</b>
<b>9.7.5 Përcaktimi i koeficientit <math>K_{c\ mid}</math></b> .....	<b>37</b>
<b>9.7.6 Përcaktimi i koeficientit <math>K_{c\ end}</math></b> .....	<b>37</b>
9.8 Norma e ujitjes.....	38



9.9 Llogaritja e shiut efektiv.....	38
<b>10. Kulturat bujqesore qe mbillen sot.....</b>	<b>39</b>
<b>11. Ndarja Klimatike E Shqiperise.....</b>	<b>50</b>
11.1 Zonat Dhe Nenzonat Klimatike.....	53
11.2 Zona mesdhetare fushore.....	54
11.3 Zona mesdhetare kodrinore.....	58
11.4 Zona mesdhetare para malore.....	63
11.5 Zona mesdhetare malore.....	66
<b>12. Tipet e tokave të Shqiperise.....</b>	<b>72</b>
12.1 Toka dhe llojet e saj.....	72
12.2 Ndërtimi granulometrik apo tekstura e tokës.....	72
12.3 Struktura E Tokës.....	73
12.4 Poroziteti.....	75
12.5 Dendësia.....	76
12.6 Përshkueshmëria dhe shpejtësia e filtrimeve.....	76
12.7 Magazinimi i ujit në tokë.....	78
12.8 Ngopja.....	78
12.9 Klasifikimi i tokave.....	78
<b>13. Harta e shtresës mesatare vjetore të reshjeve.....</b>	<b>83</b>
<b>14. Harta e Evapotranspirimit për Shqipërinë.....</b>	<b>89</b>
<b>15. Përcaktimi i Evapotranspiracionit të bimës ( ETC ) dhe normës së ujitjes ( M ).....</b>	<b>91</b>
<b>16. Konkluzione.....</b>	<b>97</b>
<b>17. Referencat.....</b>	<b>98</b>

## Lista e figurave

Figura 1: Vënd ndodhja e stacioneve në hartën e Shqipërisë.....	24
Figura 2: Paraqitje e thjeshtuar e mases së sipërfaqes dhe rezistencave aerodinamike për lëvizjen e avujve të ujit ( FAO – 56 ).....	26
Figura 3: Karakteristikat e bimës referuese ( FAO – 56 ).....	27
Figura 4: Kurba e koefiçentit të karrotës.....	34
Figura 5: Zonat klimaterike të Shqipërisë ( Atlas Klimatik i Shqiperise 1988).....	53
Figura 6: Harta e tokave të Shqipërisë .....	82
Figura 7: Harta e shtresës vjetore të shiut efektiv me 75 % siguri.....	87
Figura 8: Harta e shtresës vjetore të shiut efektiv me 90 % siguri.....	88
Figura 9: Harta e shtresës vjetore të ETo ( mm/vit ).....	90
Figura 10: Kurba mesatare e koefiçentit të bimës së karrotës për Shqipërinë .....	92
Figura 11: Harta e shtresës vjetore të ETc për bimën e karrotës gjatë kohës së zhvillimit ( mm ) .....	94
Figura 12: Harta e normës së ujitjes me 75 % siguri për bimën e karrotës ( mm ).....	95
Figura 13: Harta e normës së ujitjes me 90 % siguri për bimën e karrotës ( mm ).....	96

## Lista e tabelave

Tabela 1: Evapotranspirimi potencial sipas muajve ( mm/ditë ) ( Ministria e Bujqësisë ) .....	12
Tabela 2: Evapotranspirimi maksimal për bimët e arave ( m <sup>3</sup> /ha ) ( Ministria e Bujqësisë ).....	13
Tabela 3: Evapotranspirimi maksimal për pemtarinë ( m <sup>3</sup> /ha ) ( Ministria e Bujqësisë ) .....	13
Tabela 4: Normat e ujitjes për bimët e arave ( m <sup>3</sup> /ha ) ( Ministria e Bujqësisë ) .....	14
Tabela 5: për bimët e arave në tokat e pjerrëta dhe në fushat e brendëshme ( m <sup>3</sup> /ha ) ( Ministria e Bujqësisë ).....	14
Tabela 6: Për pemëtarinë në tokat e pjerrëta dhe në fushat e brendëshme ( m <sup>3</sup> /ha ) ( Ministria e Bujqësisë ).....	15
Tabela 7: Normat mesatare te ujitjes për struktura tokash të ndryshme ( m <sup>3</sup> /ha ) ( Ministria e Bujqësisë ).....	15
Tabela 8: Hidromodulet maksimale sipas kulturave (l/s/ha ) ( Ministria e Bujqësisë ) .....	16
Tabela 9: Vlerat e evapotranspirimit vjetor sipas autorëve të ndryshëm dhe reshjeve mesatare vjetore ( Nezir Nota 1983 ) .....	18
Tabela 10: Vlerat e evapotranspirimit 3 dhe 6 mujor sipas autorëve të ndryshëm ( Nezir Nota 1983 ).....	19
Tabela 11: Tabela e të dhënave nga projekti POWER ( POWER ) .....	22
Tabela 12: Tabela e koordinatave të stacioneve të të dhënave.....	23
Tabela 13: Kriteret e përgjithshme për qasjen me një ose dy koeficientë ( FAO - 56 ).....	33
Tabela 14: Kohëzgjatja e për faza të ndryshme të zhvillimit të bimës ( FAO - 56 ).....	35
Tabela 15: Koeficienti K <sub>c</sub> për faza të ndryshme të zhvillimit të bimës ( FAO - 56 ).....	36
Tabela 16: Sipërfaqja e mbjellë në ha e bimëve të arave ( INSTAT ) .....	49
Tabela 17: Tabela e sipërfaqeve dhe llojit të tokave në shqipëri ( Pandi Zdruli dhe Sherif Lushaj ) .....	79
Tabela 18: Klasifikim i tokave si mbas US Taxonomy ( Pandi Zdruli dhe Sherif Lushaj ).....	81
Tabela 19: Tabela e shtresës së shiut efektiv 1981 ÷ 2020 për Stacionin Nr.1 .....	84
Tabela 20: Tabela e shtresës së shiut efektiv me 75 & 90 % siguri .....	84
Tabela 21: Tabela e shtresës së shiut efektiv me 75 % siguri për 24 stacione .....	85
Tabela 22: Tabela e shtresës së shiut efektiv me 90 % siguri për 24 stacione .....	86
Tabela 23: Tabela e shtresës së Evaporacionit referues ( ETo ) vjetor për stacionit ( mm/vit ).....	89
Tabela 24: Tabela e bimëve dhe krakteristikat e zhvillimit të tyre .....	91
Tabela 25: Tabela e bimëve dhe krakteristikat e zhvillimit të tyre për stacionin Nr.1 .....	92
Tabela 26: Tabela e evapotranspiracionit të bimës së karrotës për stacionet.....	93

## 2. Hyrje

Shqipëria është një vënd ku rreth 50% të punësimit e zë bujqësia dhe si e tillë, ajo ka nevojë që resurset që ka për të zhvilluar këtë sektor ti shfrytëzojë në mënyrë sa më optimale.

Në total, toka bujqësore zë një sipërfaqe prej 695 000 ha (24% të sipërfaqes totale të vendit), nga të cilat rreth 360 000 ha vlerësohet që mund të ujitet, dhe rreth 120 000 ha janë potencialisht të ujitshme .

Ujitja e këtyre sipërfaqeve bëhet kryesisht me rrjedhje të lirë, dhe kanalet ujitëse kanë një efiçencë prej 30 ÷ 60 % , që do të thotë që një pjesë relativisht e madhe e ujit nuk shfrytëzohet .

Për të bërë një administrim sa më të mirë të burimeve ujore në funksion të zhvillimit të bujqësisë, duhet në rradhë të parë që të përcaktohet sa më mirë dhe sasia e ujit që duhet për ujitje, kjo pasi dhe llojet dhe numri i bimëve që mbillen tani, ndryshojnë me ato që janë mbjellur përpara viteve 90 .

## 3. Qëllimi i studimit

Për të përcaktuar Evapotranspirimin e bimës, në Shqipëri janë përdorur metoda të ndryshme, ky punim do të bazohet në metodën FAO Penman-Monteith e publikuar FAO Irrigation and Drainage Paper No. 56 ( FAO – 56 ) , si një standart i ri për të llogaritur Evapotranspirimin potencial për bimë të ndryshme .

Ky punim ka si qëllim që të hatojë hartat e Shqipërisë për:

- Evapotranspiracionin referues ( ETo ), në bazë mujore dhe atë vjetore.
- Shiun efektiv me 75 dhe 90 % siguri në bazë mujore dhe vjetore.
- Evapotranspirimin për bimë të ndryshme për të gjithë kohën e vegjetacionit.
- Normat e ujitjes për shiun efektiv me 75 dhe 90 % siguri për të gjithë kohën e vegjetacionit.

Ky material mund të shërbejë në të ardhmen si nje udhëzes për të llogaritur normat e ujitjes për bimë të ndryshme që nuk janë të përfshira në këtë punim, por mund të shërbejë dhe për planifikimin dhe projektimin e veprave të ndryshme ujitëse ..

## 4. Të përgjithshme

### 4.1 Procesi i Evapotranspirimit

Kombinimi i dy proceseve të ndara sipas të cilave uji humbet nga sipërfaqja e tokës për shkak të avullimit dhe nga bimët për shkak të transpirimit përcaktohet si Evapotranspirim (ET).

### 4.2 Avullimi

Avullimi është procesi përmes të cilit uji i lëngshëm shndërrohet në avuj uji (avullimi) dhe largohet nga sipërfaqja e avullimit. Uji avullohet nga sipërfaqe të ndryshme, të tilla si liqene, lumenj, trotuare, toka dhe bimësia.

Për të ndryshuar gjendjen e molekulave të ujit nga lëngu në avull kërkohet një energji e caktuar. Rrezatimi diellor i drejtpërdrejtë dhe, temperatura e ambientit të ajrit e sigurojnë këtë energji të nevojshme. Forca lëvizëse për të larguar avujt e ujit nga sipërfaqja e avullimit është ndryshimi midis presionit të avullit të ujit në sipërfaqen e avullimit dhe asaj të atmosferës përreth. Ndërsa avullimi vazhdon, ajri përreth ngopet gradualisht dhe ky proces do të ngadalësohet dhe mund të arrijë në një pikë që të ndalet nëse ajri i lagësht nuk do të transferohet në atmosferë. Zëvendësimi i ajrit të ngopur me ajër më të thatë varet shumë nga shpejtësia e erës. Prandaj, rrezatimi diellor, temperatura e ajrit, lagështia e ajrit dhe shpejtësia e erës janë parametra klimatike që duhet të merren parasysh kur vlerësohet procesi i avullimit. Aty ku sipërfaqja e avullimit është sipërfaqja e tokës, përqindja e hijezimit nga bimët dhe sasia e ujit të disponueshëm në sipërfaqen e avullimit janë faktorë të tjerë që ndikojnë në procesin e avullimit. Shirat e shpeshtë, ujitja dhe uji i ardhur nga ujrat e cekëta nëntokësore i japin lagështirë sipërfaqes së tokës. Kur toka është në gjendje të japë ujë që të plotësojë kërkesën për avullim, avullimi nga toka përcaktohet vetëm nga kushtet meteorologjike. Sidoqoftë, kur intervali midis shirave dhe ujitjes bëhet i madh dhe aftësia e tokës për të përcjellë lagështirë afër sipërfaqes është e vogël, përmbajtja e ujit në pjesën e sipërme të tokës bie dhe sipërfaqja e tokës thahet. Në këto rrethana disponueshmëria e kufizuar e ujit ushtron një ndikim kontrollues në avullimin e tokës. Në mungesë të çdo furnizimi me ujë në sipërfaqen e tokës, avullimi zvogëlohet shpejt dhe mund të pushojë pothuajse plotësisht brenda disa ditësh.

### 4.3 Transpirimi

Transpirimi konsiston në avullimin e ujit të lëngshëm në kërcejtë e bimës dhe largimin e avujve në atmosferë. Bimët kryesisht e humbasin ujin e tyre përmes gojëzave. Këto janë hapje të vogla në fletën e bimës përmes së cilave kalojnë gazrat dhe avujt e ujit. Uji, së bashku me disa lëndë ushqyese, merret nga rrënjët dhe transportohet përmes bimës. Avullimi ndodh brenda fletës, përkatësisht në hapësirat ndërqelizore, dhe shkëmbimi i avullit me atmosferën kontrollohet nga hapja e gojëzave. Pothuajse i gjithë uji i marrë humbet nga transpirimi dhe vetëm një fraksion i vogël përdoret brenda në bimë.

Transpirimi, si avullimi i drejtpërdrejtë, varet nga furnizimi me energji, gradienti i presionit të avullit dhe era. Prandaj, rrezatimi, temperatura e ajrit, lagështia e ajrit dhe era duhet që të merren parasysh kur vlerësohet transpirimi. Përmbajtja e ujit të tokës dhe aftësia e tokës për të përcjellë ujin të rrënjët përcaktojnë gjithashtu shpejtësinë e transpirimit. Shkalla e transpirimit ndikohet gjithashtu nga karakteristikat e bimëve, aspektet mjedisore dhe mënyrat e kultivimit. Lloje të ndryshme të bimëve mund të kenë shpejtësi të ndryshme transpirimi. Jo vetëm lloji i bimëve, por edhe zhvillimi i tyre, ambienti dhe menaxhimi duhet të merren parasysh kur vlerësohet transpirimi.

### 4.4 Evapotranspirimi

Avullimi dhe transpirimi ndodhin njëkohësisht dhe nuk ka mënyrë të thjeshtë për të bërë dallimin midis dy proceseve. Përveç gjendjes së ujit në shtresën e sipërme, avullimi nga një tokë e mbjellë përcaktohet kryesisht nga fraksioni i rrezatimit diellor që arrin në sipërfaqen e tokës. Ky fraksion zvogëlohet gjatë periudhës së rritjes ndërsa bima zhvillohet dhe kurora e bimës lëshon hije gjithnjë e më shumë në sipërfaqen e tokës. Kur bima është e vogël, uji kryesisht humbet nga avullimi i tokës, por kur bima zhvillohet mirë dhe arrin të mbulojë plotësisht tokën, transpirimi bëhet procesi kryesor. Në fazën e parë atë të mbjelljes gati 100% e evapotranspiracionit vjen nga avullimi, ndërsa me rritjen e plotë të bimës, më shumë se 90% e ET vjen nga transpirimi.

## 5. Faktorët që ndikojnë në evapotranspirimi

Parametrat e motit, karakteristikat e të korrave, aspektet e menaxhimit dhe mjedisit janë faktorë që ndikojnë në avullimin dhe transpirimin.

### 5.1 Parametrat e motit

Parametrat kryesorë të motit që ndikojnë në evapotranspirim janë rrezatimi, temperatura e ajrit, lagështia dhe shpejtësia e erës. Fuqia e avullimit të atmosferës shprehet me avullimin e bimës referuese (ET<sub>o</sub>). Evapotranspirimi i bimës referuese përfaqëson evapotranspirimin nga një sipërfaqe e standardizuar e mbjell.

### 5.2 Lloji i bimës

Lloji i bimës, larmia dhe faza e zhvillimit të saj duhet të merren parasysh kur vlerësohet evapotranspirimi nga bimët në fusha të mëdha. Dallimet në rezistencën ndaj transpirimit, lartësisë së bimës, ashpërsisë së bimës, reflektimit, mbulesës së tokës dhe karakteristikave të rrënjes së bimëve sjellin nivele të ndryshme të evapotranspirimit, në lloje të ndryshme bimësh nën kushte të njëjta mjedisore. Evapotranspirimi i bimës në kushte standarde (ET<sub>c</sub>) i referohet kërkesës së avullimit nga bimët që rriten në fusha të mëdha nën ujtitje optimale të tokës, menaxhim të shumë të mirë dhe arrin prodhim të plotë në këto kushte klimatike.

### 5.3 Kushtet e menaxhimit dhe mjedisit

Faktorë të tillë si kripësia e tokës, pjelloria e dobët e tokës, aplikimi i kufizuar i plehrave, prania e shtresave të padepërtueshme të tokës, mungesa e kontrollit të sëmundjeve dhe dëmtuesve dhe menaxhimi i dobët i tokës mund të kufizojnë zhvillimin e bimëve dhe të zvogëlojnë evapotranspirimin. Faktorë të tjerë që duhet të merren parasysh kur vlerësohet evapotranspirimi janë mbulesa e tokës, dendësia e bimëve dhe sasia e ujit në tokë. Efekti i sasisë së ujit në tokë në evapotranspirim kushtëzohet kryesisht nga madhësia e deficitit të ujit dhe tipi i tokës. Nga ana tjetër, shumë ujë do të rezultojë në sasi e madhe uji në zonën e rrënjëve mund të dëmtojë ato dhe të kufizojë marrjen e ujit nga rrënjët duke penguar frymëmarrjen.

Kur vlerësohet shkalla e evapotranspirimit, duhet t'i kushtohet vëmendje shtesë praktikave të ndryshme të menaxhimit që veprojnë në faktorët klimatikë dhe bimëve që ndikojnë në procesin e evapotranspirimit. Mënyrat e mbjelljes dhe lloji i metodës së ujitjes mund të ndryshojnë mikroklimën, të ndikojnë në karakteristikat e kulturave ose të ndikojnë në lagështinë e tokës dhe sipërfaqes së bimës . Një masë për pengimin e lëvizjes së erës, zvogëlon shpejtësinë e saj duke ulur evapotranspiracionin. Ky efekt mund të jetë i rëndësishëm sidomos në kushte me erë, të ngrohtë dhe të thatë. Avullimi i tokës në një pemëtore, ku pemët janë të vendosura në distanca të mëdha, mund të zvogëlohet duke përdorur një sistem të ujitje me pika. Pikat vendosin ujë direkt në tokë afër pemëve, duke lënë kështu pjesën më të madhe të sipërfaqes së tokës të thatë dhe duke kufizuar humbjet e avullimit. Mbulimi i sipërfaqeve , veçanërisht kur të korrat janë të vogla, është një mënyrë tjetër për të ulur ndjeshëm avullimin e tokës.



## 6. Kulturat bujqësore dhe probleme të tjera të agroteknikës deri në vitet 90.

### 6.1 Vështrim mbi normat egzistuese të ujitjes në vëndin tonë

Llogaritja e nevojave për ujë mbi bazën e llogaritjes së evapotranspirimit të bimëve bujqësore është bërë para viteve 90 me anën e disa metodave të ndryshme, për qëllimin e planifikimit dhe vlerësimit të nevojave për ujë, sidomos në projektimin e rezervuarëve për ujitjen, e më pas në përmirësimin e sitemit ujitës .

Rezultatet e këtyre studimeve janë si më poshte :

Stacioni	Evapotranspirimi potencial sipas muajve në ( mm/ditë )					
	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator
Sarandë	3.5	4.6	5.8	6.3	5.7	4.0
Lushnjë	3.1	4.2	5.5	6.1	5.3	3.7
Shkodër	2.9	3.9	5.2	5.8	5.2	3.8
Kamëz	2.8	3.9	5.0	5.6	4.8	3.2
Burrel	2.7	3.7	4.8	5.2	4.4	2.9
Korçë	2.7	3.6	4.5	4.9	4.3	3.0
Ersekë	2.6	3.5	4.1	5.0	4.1	2.6
Razëm	2.3	3.4	4	4.4	4.2	2.8

**Tabela 1:** Evapotranspirimi potencial sipas muajve ( mm/ditë ) ( Ministria e Bujqësisë )

Duke patur parasysh vlerat e Evapotranspirimit potencial u kalua në llogaritjen e nevojave për ujeë për bimët e ndryshme, në zona të ndryshme të Shqipërisë, për të arritur një rendiment maksimal të këtyre bimëve .

Stacioni	Nevojat për ujë, në m <sup>3</sup> /ha							
	Misër	Jonxhë	Foragjere të para	Foragjere të dyta	Luledielli	Pambuk	Panxhar	Grurë
Sarandë	8060	9120	8160	5760	5600	5840	-	2260
Lushnjë	7580	8500	7690	5460	5240	5470	-	2010
Shkodër	7200	8050	7270	5210	4960	-	-	1900
Kamëz	6900	7720	6960	4950	4790	-	-	1840
Burrel	6450	7260	6510	4560	3850	-	-	1760
Korçë	5780	6580	5490	3730	-	-	6820	2720
Ersekë	5210	6010	5330	2630	-	-	-	2640
Razëm	4820	5600	4970	2670	-	-	-	2460

**Tabela 2:** Evapotranspirimi maksimal për bimët e arave ( m<sup>3</sup>/ha ) ( Ministria e Bujqësisë )

Stacioni	Nevojat për ujë, në m <sup>3</sup> /ha			
	Pemët	Agrumet	Ullinjë	Vreshtat
Sarandë	6000	8200	5500	5800
Lushnjë	5600	7660	5100	5500
Shkodër	5300	-	-	5100
Kamëz	5100	-	4650	4900
Burrel	4800	-	-	4650
Korçë	4650	-	-	4550
Ersekë	4500	-	-	-

**Tabela 3:** Evapotranspirimi maksimal për pemtarinë ( m<sup>3</sup>/ha ) ( Ministria e Bujqësisë )

Duke patur parasysh Evapotranspirimin maksimal për bimët e ndryshme ky studim llogariti dhe normat e ujitjes duke patur parasysh dhe reshjet atmosferike .

Nr .	Rrethet	Normat e ujitjes në m <sup>3</sup> /ha											
		Misër	Jonxhë	Foragjere të para	Foragjere të dyta	Luledielli	Pambuk	Panxhar	Grurë	Perimet	Fasule	Patate	Duhana
1	Sarandë, Vlorë	5300	5800	5000	4200	3500	3600	-	1100	5800	3500	3500	3500
2	Gjirokastrë	5000	5500	4800	4000	3300	-	-	1000	5500	3300	3300	3300
3	Fier, Lushnjë, Durrës, Elbasan, Berat	4800	5300	4600	3900	3100	3200	-	1000	5300	3100	3100	3100
4	Tiranë, Krujë, Lezhë, Shkodër	4000	4000	3700	3300	2400	-	-	500	4000	2400	2400	2400
5	Korçë, Pogradec	3600	4100	3300	2500	-	-	4100	1300	4100	-	-	-

*Tabela 4: Normat e ujitjes për bimët e arave ( m<sup>3</sup>/ha ) ( Ministria e Bujqësisë )*

Nr.	Rrethet	Nevojat për ujitje, në m <sup>3</sup> /ha							
		Misër	Jonxhë	Foragjere të para	Foragjere të dyta	Luledielli	Pambuk	Panxhar	Grurë
1	Sarandë, Vlorë	6300	7000	6200	5000	4100	-	-	1200
2	Fier, Lushnjë, Durrës, Elbasan	5900	6400	5800	4600	3800	-	-	1100
3	Gjirokastrë, Tepelenë, Përmet, Berat, Skrapar, Gramsh, Librazhd	5300	5700	5200	4200	3400	-	-	1300
4	Tiranë, Krujë, Lezhë, Shkodër	5000	5200	4700	4100	3000	-	-	600
5	Korçë, Pogradec, Kolonjë, Dibër, Kukës, Tropojë, Pukë	4500	5200	4200	3200	-	-	5200	1400
6	Mat, Mirditë	4300	4400	4100	3600	2000	-	-	400

*Tabela 5: për bimët e arave në tokat e pjerrëta dhe në fushat e brendëshme ( m<sup>3</sup>/ha ) ( Ministria e Bujqësisë )*

Nr.	Rrethet	Nevojat për ujë, në m <sup>3</sup> /ha		
		Pemët e vreshtat	Agrumet	Ullinjtë
1	Sarandë	3700	5900	3200
2	Vlorë	3500	5700	3000
3	Fier, Berat, Lushnjë	3300	5400	2800
4	Gjirokastër, Tepelenë, Skrapar, Librazhd, Gramsh	3000	-	-
5	Durrës, Elbasan	3000	5000	2400
6	Korçë, Kolonjë, Pogradec, Kukës, Peshkopi	2800	-	-
7	Tiranë, Krujë	2500	-	2100
8	Lezhë, Shkodër	2200	-	2100
9	Mat, Mirditë	1800	-	-
10	Pukë, Tropojë	1500	-	-

**Tabela 6:** Për pemëtarinë në tokat e pjerrëta dhe në fushat e brendëshme ( m<sup>3</sup>/ha )  
( Ministria e Bujqësisë )

Nr.	Rrethet	Nevojat mesatare për ujitje, në m <sup>3</sup> /ha		
		Zona fushore	Zona kodrinore dhe fushat e brendëshme	Malësia
1	Sarandë	4600	4300	-
2	Gjirokastër, Vlorë	4400	4100	-
3	Fier, Lushnjë, Durrës	4200	4000	-
4	Berat	4200	4000	2500
5	Tepelenë, Përmet, Skrapar, Gramsh, Librazhd	-	3700	2500
6	Elbasan, Tiranë	4000	3700	2500
7	Korçë, Pogradec	3400	3200	2500
8	Kolonjë	-	3200	2500
9	Krujë	3400	2900	2000
10	Lezhë	3400	2900	-
11	Shkodër	3400	2900	1500
12	Dibër, Kukës,	-	2900	2500
13	Mat, Mirditë	-	2900	2000
14	Tropojë, Pukë	-	2500	1500

**Tabela 7:** Normat mesatare te ujitjes për struktura tokash të ndryshme ( m<sup>3</sup>/ha )  
( Ministria e Bujqësisë )

Ndërsa hidromodulet maksimale të ujitjes janë si më poshtë :

Stacioni	Hidromoduli maksimal në korrik (lit/sek.ha neto) sipas kulturave						
	Misër	Jonxhë	Foragjere të para	Foragjere të dyta	Luledielli	Pambuk	Panxhar
Sarandë	0.96	0.88	0.92	1.22	0.74	0.88	-
Lushnjë	0.92	0.84	0.89	1.17	0.72	0.84	-
Shkodër	0.89	0.82	0.85	1.14	0.68	-	
Kamëz	0.85	0.77	0.80	0.96	0.66	-	-
Burrel	0.80	0.72	0.76	1.01	0.61	-	-
Korçë	0.76	0.67	0.71	0.96	0.58	-	0.76
Ersekë	0.77	0.70	0.73	0.98	-	-	-
Razëm	0.67	0.61	0.65	0.79	-	-	-

*Tabela 8: Hidromodulet maksimale sipas kulturave (l/s/ha) ( Ministria e Bujqësisë )*

## 7. Metodatat dhe të dhënat e përdorura për vlerësimin e normave të ujitjes .

Disa nga metodatat që janë përdorur para viteve 90 në vëndin tonë janë :

### 7.1 Metoda Blaney – Criddle

Për të përcaktuar Evapotranspirimin potencial kjo metodë përdor të dhënat e temperaturës së orëve ditore dhe të lagështisë së ajrit .

Kjo formulë ka formën :

$$Etc = K \frac{(T+18)}{2.2} p \quad (1)$$

Ku Etc – Evapotranspirimi potencial ( mm )

K – Koefiçenti fiziologjik i bimës

T – Temperatura mesatare mujore ne ( °C )

p – Përqindja mesatare mujore të orëve ditore, kundrejt orëve të të gjithë vitit

### 7.2 Metoda Thornthwaite

E njerrë nga Thornthwaite në vitet 1944 ÷ 1948 për vënde me reshje mesatare formula ka formën :

$$Etc = 1.6 \left( \frac{10 t}{I} \right) \quad (2)$$

Ku Etc – Evapotranspirimi potencial mujor ( cm )

t – Temperatura mesatare mujore ne ( °C )

I – Treguesi i nxehtësisë mujore

### 7.3 Metoda Quijano

E njerrë nga Quijano në vitin 1960, kjo formulë është e ngjashme me atë të Blaney – Criddle por që nuk merr parasysh koeficientin e kulturave K dhe ka formën :

$$Etc = F \cdot t \quad (3)$$

Ku Etc – Evapotranspirimi potencial mujor ( mm )

t – Temperatura mesatare mujore ne ( °C )

F – Koeficient mujor që merret në tabela për gjerësi gjeografike të ndryshme .

Nr.	Stacionet	Reshjet mesatare vjetore ( mm )	Metodat			
			Blaney Cridle ( mm )	Thornthwait ( mm )	Quijano ( mm )	L. Turc ( mm )
1	Shkodër	1927	1089.5	824.9	686.6	892.8
2	Lezhë	1643	1114.9	833.9	892.8	-
3	Durrës	983	1123.2	834.3	891.0	1076.3
4	Tiranë	1172	1103.7	813.4	860.6	1024.3
5	Kavajë	1060	1099.4	800.5	850.4	-
6	Elbasan	1157	1107.4	818.7	863.3	1012.5
7	Lushnjë	1002	1128.3	840.8	896.6	1098.1
8	Kuçovë	958	1109.1	823.8	864.3	1076.7
9	Fier	1024	1097.3	803.0	843.4	1099.2
10	Vlorë	1090	1140.5	857.5	901.2	1130.9
11	Sarandë	1509	1169.5	906.1	932.9	1117.9
12	Burrel	1143	1041.0	748.5	776.2	929
13	Krujë	1697	1059.0	764.7	799.8	-
14	Tepelenë	1683	1100.6	824.5	844.6	-
15	Tropoje	1846	994.4	898.3	705.6	-
16	Gjirokastër	1708	1076.2	789.4	802.7	998.9
17	Kukës	880	998.4	716.2	711.7	818.5
18	Korçë	722	942.1	660.2	637.0	838.4

*Tabela 9: Vlerat e evapotranspirimit vjetor sipas autorëve të ndryshëm dhe reshjeve mesatare vjetore ( Nezir Nota 1983 )*

Nr.	Stacionet në:	Lartesia nga deti	ETP 6-mujor			ETP 3-mujor		
			Blaney Criddle ( mm )	Thornthwaite ( mm )	Quijano ( mm )	Blaney Criddle ( mm )	Thornthwaite ( mm )	Quijano ( mm )
1	Lukovë	222	726.86	674.37	686.59	406.02	426.35	427.92
2	Tepelenë	220	714.05	662.75	666.55	399.91	415.16	416.78
3	Berat	226	708.01	642.75	658.94	390.36	405.05	409.97
4	Çorovodë	410	700.66	629.39	643.87	392.14	397.32	402.65
5	Krujë	560	686.45	604.54	622.03	386.02	381.55	388.68
6	Kuç	610	685.66	606.69	608.96	387.41	388.72	384.21
7	Dajt	650	672.79	587.04	598.75	377.15	365.75	373.35
8	Burrel	309	688.49	617.00	625.20	386.97	387.22	389.87
9	Kukës	354	679.25	614.8	607.39	383.60	385.81	381.34
10	Dragobi	325	659.40	582.17	638.85	373.97	367.39	358.56
11	Bulqizë	635	635.67	526.16	542.72	358.39	325.42	337.11

*Tabela 10: Vlerat e evapotranspirimit 3 dhe 6 mujor sipas autorëve të ndryshëm ( Nezir Nota 1983 )*



## 8. Të dhënat meteorologjike

**Të dhënat meteorologjike të përdorura për këtë punim janë marrë nga projekti NASA Langley Research Center ( POWER ) i krijuar nga NASA Earth Science Directorate Applied Science Program .**

Projekti NASA Langley Research Center (POWER) financohet nëpërmjet Programit të Shkencave të Aplikuara të NASA-s në kuadër të Drejtorisë së Misionit të Shkencës së Tokës. POWER ndihmon për të siguruar që komunitetet të kenë akses në energji të besueshme mes ndryshueshmërisë në rritje të klimës. Ata e arrijnë këtë duke ofruar produkte të dhënash të gatshme për analiza nga Vëzhgimet e Tokës dhe modelimin e NASA-s për të mbështetur komunitetin e kërkimit dhe inxhinierisë mbi energjinë e rinovueshme dhe efikasitetin e energjisë së ndërtimit.

POWER mbështet tre komunitete përdoruesish me të dhëna diellore dhe/ose meteorologjike:

- Energjia e Rinovueshme (RE),
- Ndërtesat e qëndrueshme (SB)
- Agroklimatologjia (AG).

Burimet e të dhënave të POWER:

Projekti POWER ofron akses në të dhënat e gatshme (ARD) për meteorologjinë dhe parametrat e lidhur me diellin, të formuluar posaçërisht për vlerësimin dhe projektimin e sistemeve të energjisë së rinovueshme.

- Të dhënat janë të disponueshme në rrjetin global të gjerësisë dhe gjatësisë gjeografike .
- Nivelet kohore përfshijnë orë, ditore, mujore, vjetore dhe klimatologji.
- Opsionet e shkarkimit përfshijnë të dhëna të vetme, rajonale dhe globale.
- Formatet përfshijnë NetCDF, CSV, ASCII, geoJSON, ICASA dhe EPW.
- Parametrat meteorologjikë janë nga:
  - Arkivi GMAO MERRA-2 i NASA-s (1 janar 1981 – 3 muaj prapa në kohën e tanishme)
  - Arkivi GEOS 5.12.4 FP-IT i NASA-s (Fundi i MERRA2 – afër kohës së tanishme)

- Parametrat e diellit janë nga:
  - NASA's GEWEX/SRB Versioni 4.0 (Janar. 1, 1984 – Dhjetor. 31, 2000)
  - NASA's CERES SYN1deg (Janar 1, 2001 – 3 muaj nga koha e tanishme)
  - NASA's FLASHFlux (Janar 1, 2008 – koha e tanishme)

Të dhënat e disponueshme të projektit POWER ( Link: <https://power.larc.nasa.gov/data-access-viewer/> ) janë për një rezolucion  $1^\circ \times 1^\circ$  gjërësi/gjatësi gjeografike për të dhënat që vijnë nga rrezatimi diellor dhe me një rezolucion  $1/2^\circ \times 5/8^\circ$  gjërësi/gjatësi gjeografike për të dhënat meteorologjike.

Duke patur parasysh këtë, për të shkarkuar të dhënat për këtë punim, janë marrë 24 stacione ( pika të dhënash ) . Për secilën nga këto pika ( stacione ) janë marrë të dhënat ditore për :

- Temperaturën maksimale në 2 m lartësi ( T2M\_MAX )
- Temperaturën miniamle në 2 m lartësi ( T2M\_MIN)
- Temperaturën e pikës së vesës në 2 m lartësi ( T2MDEW )
- Shtresën e reshjeve ditore ( PRECTOTCORR )
- Shpejtësinë e erës në 2 m lartësi ( WS2M )
- Presionin atmosferik ( PS )

Për të 6 parametrat e mësipërm janë marrë të dhënat ditore nga 03 – Janar – 1981 dhe deri në 31 – Dhjetor 2020 .

-BEGIN HEADER-

NASA/POWER CERES/MERRA2 Native Resolution Daily Data

Dates (month/day/year): 01/03/1981 through 12/31/2020

Location: Latitude 39.74 Longitude 20.0

Elevation from MERRA-2: Average for 0.5 x 0.625 degree lat/lon region = 69.96 meters

Value for missing model data cannot be computed or out of model availability range: -999

Parameter(s):

T2M\_MAX MERRA-2 Temperature at 2 Meters Maximum (C)

T2M\_MIN MERRA-2 Temperature at 2 Meters Minimum (C)

T2MDEW MERRA-2 Dew/Frost Point at 2 Meters (C)

PRECTOTCORR MERRA-2 Precipitation Corrected (mm/day)

WS2M MERRA-2 Wind Speed at 2 Meters (m/s)

PS MERRA-2 Surface Pressure (kPa)

-END HEADER-

YEAR	DOY	T2M_MAX	T2M_MIN	T2MDEW	PRECTOTCORR	WS2M	PS
1981	3	11.17	11.17	5.05	1.06	0	3.56
1981	4	12.81	10.04	7.98	3.64	3.93	99.92
1981	5	13.32	8.77	7.27	9.09	7.72	99.07
1981	6	8.8	6.98	0.21	1.14	6.16	100.29
1981	7	8.35	4.94	1.81	5.9	7.3	99.72
1981	8	7.17	2.33	-0.36	1.34	6.67	99.99
1981	9	5.37	0.9	-2.02	0.21	4.37	100.27
1981	10	7.53	2.94	-1.17	0.06	2.48	100.27
1981	11	10.12	6.76	1.55	0.1	1.62	101.11
1981	12	10.86	8.41	4.42	1.48	2.62	101.49
1981	13	12.56	10.48	8.9	9.06	8.22	100.57
1981	14	13.83	10.44	6.9	10.17	6.23	99.77
1981	15	10.85	8.62	6.44	6.13	3.32	99.3
1981	16	12.48	6.96	7.42	11.54	5.23	97.9
1981	17	10.05	5.88	1.21	0	5.55	99.85
1981	18	12.64	6.6	4.87	9.53	3.13	100
1981	19	11.49	8.15	5.08	2.15	3.12	99.88
1981	20	9.64	7.12	3.2	0.75	3.84	99.53
1981	21	8.77	6.99	2.87	4.74	9.46	98.69
1981	22	9.69	6.4	3.19	0.63	7.91	99.24
1981	23	10.61	7.03	3.87	0.61	6.02	100.26
1981	24	11.94	6.9	2.69	0.24	3.02	100.78
1981	25	8.51	6.2	3.02	1.02	2.01	100.79
1981	26	10.41	5.87	1.4	0.07	2.98	101.01
1981	27	7.83	2.55	-0.93	0.92	5.7	101.25
1981	28	6.91	2.11	-2.17	0.2	4.37	101.26
1981	29	8.22	3.26	-0.41	0.39	4.12	101.2
1981	30	11.3	5.05	1.22	0.02	3.42	101.35
1981	31	11.15	4.76	-0.65	0	2.7	101.84
1981	32	14.39	9.97	2.69	0	1.75	102.12
1981	33	14.85	10.08	5.23	0	1.12	102.15
1981	34	12.52	9.59	7.27	1.14	2.1	101.56
1981	35	11.69	9.47	7.43	3.58	3.31	100.19
1981	36	12.67	10.06	8.9	23.2	5.21	99.25
1981	37	10.98	6.99	5.07	10.92	2.51	99.22
1981	38	13.76	6.84	3.58	0.02	3.23	100.63
1981	39	14.33	8.01	3.55	0	2.66	101.35
1981	40	15.7	10.38	7.87	0	1.42	101.39
1981	41	14.55	10.29	9.55	0	2.68	101.32
1981	42	13.93	11.47	9.69	0.49	3.42	101.14
1981	43	14.3	11.68	11.65	2.57	4.67	100.47
1981	44	13.74	10.21	9.72	10.8	2.15	100.3
1981	45	10.03	5.38	5.55	10.57	5.1	99.82
1981	46	8.53	3.12	-0.4	0.22	4.93	100.52
1981	47	10.55	5.62	-0.01	0	3.59	100.85
1981	48	10.4	4.46	0.46	0.14	4.85	100.61
1981	49	9.68	4.36	0.18	0.38	3.26	100.08
1981	50	9.84	6.83	2.22	3.94	2.44	100.27
1981	51	10.62	9.64	7.28	4.56	3.58	100.69
1981	52	12.73	10.13	9.25	10.21	6.1	101
1981	53	14.19	10.16	7.58	1.62	6.02	100.62
1981	54	14.89	8.08	4.37	0.1	3.52	100.28

Tabela 11: Tabela e të dhënave nga projekti POWER ( POWER )

Koordinatat e stacioneve janë si më poshtë :

Nr.	Emërtimi	Koordinatat Gjeografike		Koordinatat UTM	
		Gjerësi	Gjatësi	Veri	Lindje
1	Sta_Nr.1	39.74	20.50	4,399,019.92	457,158.62
2	Sta_Nr.2	39.74	20.00	4,399,378.46	414,316.64
3	Sta_Nr.3	40.00	20.00	4,428,236.06	414,639.54
4	Sta_Nr.4	40.00	20.50	4,427,876.92	457,320.05
5	Sta_Nr.5	40.50	19.50	4,484,335.40	372,896.91
6	Sta_Nr.6	40.50	20.00	4,483,734.99	415,265.46
7	Sta_Nr.7	40.50	20.50	4,483,374.79	457,632.99
8	Sta_Nr.8	40.50	21.00	4,483,254.73	500,000.00
9	Sta_Nr.9	40.24	19.50	4,455,474.48	372,407.40
10	Sta_Nr.10	41.00	19.50	4,539,840.58	373,845.67
11	Sta_Nr.11	41.00	20.00	4,539,238.59	415,897.87
12	Sta_Nr.12	41.00	20.50	4,538,877.44	457,949.16
13	Sta_Nr.13	41.00	21.00	4,538,757.06	500,000.00
14	Sta_Nr.14	41.50	19.50	4,595,350.26	374,804.07
15	Sta_Nr.15	41.50	20.00	4,594,746.87	416,536.70
16	Sta_Nr.16	41.50	20.50	4,594,384.88	458,268.55
17	Sta_Nr.17	42.00	19.00	4,651,711.06	334,361.18
18	Sta_Nr.18	42.00	19.50	4,650,864.46	375,772.06
19	Sta_Nr.19	42.00	20.00	4,650,259.85	417,181.93
20	Sta_Nr.20	42.00	20.50	4,649,897.12	458,591.13
21	Sta_Nr.21	42.00	21.00	4,649,776.22	500,000.00
22	Sta_Nr.22	42.50	19.50	4,706,383.17	376,749.55
23	Sta_Nr.23	42.50	20.00	4,705,777.53	417,833.50
24	Sta_Nr.24	42.50	20.50	4,705,414.19	458,916.89

*Tabela 12: Tabela e koordinatave të stacioneve të të dhënave*




Figura 1: Vënd ndodhja e stacioneve në hartën e Shqipërisë

## 9. Metoda e përdorur për përcaktimin e normave të ujitjes

Për të përcaktuar Evapotranspirimin e bimës, ashtu siq e thamë më sipër në Shqipëri janë përdorur metoda të ndryshme, ky punim do të bazohet në metodën FAO Penman-Monteith e publikuar FAO Irrigation and Drainage Paper No. 56 ( FAO – 56 ) , si një standart i ri për të llogaritur Evapotranspirimin potencial për bimë të ndryshme .

### 9.1 Ekuacioni Penman-Monteith


Në vitin 1948, Penman ndërthuri ekuilibrin e energjisë me metodën e transferimit të masës dhe nxori një ekuacion për të llogaritur avullimin nga një sipërfaqe e hapur uji nga të dhënat standarde klimatike të rrezeve të diellit, temperaturës, lagështisë dhe shpejtësisë së erës. Ky kombinim metodash u zhvillua më tej nga shumë studiues dhe u shtri në sipërfaqe me bimë duke futur faktorët e rezistencës.

Parametrat e rezistencës së sipërfaqes shpesh kombinohen në një parametër, qe eshte “masa” e rezistencës sipërfaqësore, qe vepron në paralel me rezistencën aerodinamike.

**Rezistenca e sipërfaqes,  $r_s$** , përshkruan rezistencën e rrjedhës së avujve përmes hapjeve të gojëzave, sipërfaqes totale të gjetheve dhe sipërfaqes së tokës.

**Rezistenca aerodinamike  $r_a$** , përshkruan rezistencën nga pjesa e lartë e bimës dhe përfshin fërkimin nga lëvizja e ajrit mbi sipërfaqen e bimës .

Megjithëse procesi i shkëmbimit në një shtresë bimësie është shumë kompleks për t'u përshkruar plotësisht nga dy faktorët e rezistencës, një korrelacion i mirë mund të merret midis normave të evapotranspirimit të matur dhe atij të llogaritur, veçanërisht për një sipërfaqen uniforme të barit, qe do të merret si referencë.



**Figura 2:** Paraqitje e thjeshtuar e mases së sipërfaqes dhe rezistencave aerodinamike për lëvizjen e avujve të ujit ( FAO – 56 )

Ekuacioni i kombinuar i Penman-Monteith shprehet:

$$\lambda ET = \frac{\Delta(R_n - G) + \rho_a c_p \frac{(e_s - e_a)}{r_a}}{\Delta + \gamma \left(1 + \frac{r_s}{r_a}\right)} \quad (4)$$

Ku:  $R_n$  - është rrezatimi neto

$G$  - është fluksi i nxehtësisë së tokës

$(e_s - e_a)$  - përfaqëson deficitin e presionit të avujve të ajrit

$\rho_a$  - është dendësia mesatare e ajrit në presion konstant

$c_p$  - është nxehtësia specifike e ajrit

$\Delta$  - paraqet pjerrësinë e ngopjes së presionit të avujve

$\gamma$  - është konstantja psikrometrike

$r_s$  dhe  $r_a$  - janë masa sipërfaqësore dhe aerodinamike e rezistencës.

Modeli llogaritës Penman-Monteith siç është formuluar më sipër përfshin të gjithë parametrat që rregullojnë shkëmbimin e energjisë dhe fluksin e nxehtësisë (evapotranspirimin) nga shtrirja uniforme ebimësisë. Shumica e parametrave janë të matëshme ose mund të llogariten lehtësisht nga të dhënat e meteorologjike. Ekuacioni mund të shfrytëzohet për llogaritjen e drejtpërdrejtë të evapotranspiracionit të kulturave, pasi rezistenca sipërfaqësore dhe aerodinamike janë specifike për çdo kulturë.

Formula ( 4 ) llogarit vleren e Evapotranspiracionit total per një bimë çfardo. Për të lehtësuar llogaritjet dhe për të patur një formulë që mund të përdoret në çdo vënd pamvaresisht kushteve klimaterike, formula ( 4 ) u nxorr në funksion të një bime referuese duke marrë lartësinë e bimës 0.12 m, rezistencën e sipërfaqes 70 s/m dhe albedon 0.23 që i korrespondojnë bimës së barit, si një bimë gjërësisht e studiuar .




Figura 3: Karakteristikat e bimës referuese ( FAO – 56 )

Duke patur parasysh të dhënat për bimën referuese ekuacioni ( 4 ) merr formën :

$$ET_0 = \frac{0.408\Delta (R_n - G) + \gamma \frac{900}{T+273} u_2 (e_s - e_a)}{\Delta + \gamma(1+0.34u_2)} \quad (5)$$

Ku :  $ET_0$  - Evapotranspirimi referues (mm/ditë)

$R_n$  - është rrezatimi neto në sipërfaqen e bimës ( MJ/m<sup>2</sup>/ditë )



$G$  - është densiteti i fluksit të nxehtësisë ( MJ/m<sup>2</sup>/ditë )

$T$  - temperatura mesatare ditore e ajrit në 2 m lartësi ( °C )

$u_2$  - shpejtësia e erës në 2 m lartësi ( m/s )

$e_s$  - presioni i avujve të ngopur ( kPa )

$e_a$  - presion aktual i avujve ( kPa )

( $e_s - e_a$ ) - deficiti e ngopjes së presionit të avujve ( kPa )

$\Delta$  – pjerrësia e kurbës së presionit të avujve ( kPa/°C )

$\gamma$  - është konstantja psikrometrike

Evapotranspirimi referues ETo ofron një standard për të cilin:

- Evapotranspirimi mund të krahasohet për periudha të ndryshme të vitit ose për rajone të ndryshme
- Evapotranspirimi mund të ndërlidhet për kultura të ndryshme.

Ekuacioni përdor të dhëna të matura standarde klimaterike të rrezatimit diellor (rrezet e diellit), temperaturës së ajrit, lagështinë dhe shpejtësinë e erës. Për të siguruar integritetin e llogaritjeve, matjet e motit duhet të bëhen në 2 m (ose të konvertohen në atë lartësi) mbi një sipërfaqe të madhe të mbjellë me bar duke hijezuar tokën dhe ujitje si mbas standardit.

Ekuacioni FAO Penman-Monteith është një përafrim i thjeshtë i faktorëve fizikë dhe fiziologjikë që rregullojnë procesin e evapotranspirimit. Duke përdorur përkufizimin FAO Penman- Monteith për ETo mund të llogariten koeficientet e të mbjellave në vendet e hulumtimit duke lidhur evapotranspirimin së matur të kulturave (ETc) me ETo të llogaritura, d.m.th.,  $K_c = ET_c / ETo$ . Në qasjen e koeficientit të mbjellave, ndryshimet në kurorën e bimës dhe rezistencës aerodinamike në krahasim me bimën hipotetike të marrë për referencë merren brenda koeficientit të bimës. Faktori  $K_c$  shërben si një bashkim i ndryshimeve fizike dhe fiziologjike midis të bimës të mbjellur dhe asaj të referuar .

## 9.2 Presioni atmosferik

Presioni atmosferik  $P$ , është presioni që ushtron pesha e atmosferës së tokës. Presioni atmosferik mund të matet me barometër, por në mungesë të të dhënave ai mund të llogaritet me një saktësi të kënaqshme për temperaturën  $20\text{ }^{\circ}\text{C}$  si më poshtë :

$$P = 101.3 \left( \frac{293 - 0.0065z}{293} \right)^{5.26} \quad (6)$$

ku  $P$  – presioni atmosferik ( kPa )

$z$  – lartësia nga niveli i detit ( m )

## 9.3 Konstantja psikrometrike

Konstantja psikometrike jepet si më poshtë :

$$\gamma = \frac{c_p P}{\varepsilon \lambda} = 0.665 \times 10^{-3} P \quad (7)$$

ku  $\gamma$  – konstantja psikrometrike ( kPa/ $^{\circ}\text{C}$  )

$P$  – presioni atmosferik ( kPa )

$\lambda$  – nxehtësia e nevojshme për avullimin,  $2.45$  ( MJ/kg )

$c_p$  – nxehtësia specifike në presionin konstant,  $1.013 \times 10^{-3}$  ( MJ/kg / $^{\circ}\text{C}$  )

$\varepsilon$  – raporti molekular i peshës së avujve të ujit / ajrin e thatë =  $0.622$

## 9.4 Presioni messatar i ngopjes së avujve ( $e_s$ )

Ngopja e presionit të avujve është e lidhur me temperaturën e ajrit, dhe mund të llogaritet

$$e^o(T) = 0.6108 e^{\left(\frac{17.27T}{T+237.3}\right)} \quad (8)$$

ku  $e^o(T)$  – ngopja e presionit të avujve në temperaturën e ajrit T ( kPa )

T – temperatura e ajrit ( °C )

Mqs ekuacioni i mësipërm nuk është linear, vlera mesatare ditore e ngopjes së presionit të avujve mund të llogaritet nga mesatarja e temperaturës maksimale të ajrit me atë minimale.

$$e_s = \frac{e^o(T_{max}) + e^o(T_{min})}{2} \quad (9)$$

Pjerrësia e kurbës së ngopjes së presionit të avujve (  $\Delta$  )

$$\Delta = \frac{4098 \left[ 0.6108 e^{\left(\frac{17.27T}{T+237.3}\right)} \right]}{(T+237.3)^2} \quad (10)$$

ku  $\Delta$  – pjerrësia e kurbës së presionit të avujve për temperaturën e ajrit ( kPa/°C )

T – temperatura e ajrit ( °C )

Presioni i avujve të ujit (  $e_a$  ) llogaritur nga temperatura e pikës së vesës (  $T_{dew}$  )

Temperatura e pikës së vesës, është temperatura në të cilën ajri duhet të ftohet për të ngopur ajrin .

$$e_a = e^o(T_{dew}) 0.6108 e^{\left(\frac{17.27T_{dew}}{T_{dew}+237.3}\right)} \quad (11)$$

## 9.5 Rrezatimi neto ( $R_n$ )

Rrezatimi neto (  $R_n$  ) është si diferencë e rrezatimit valëshkurtër hyrës (  $R_{ns}$  ) dhe rrezatimi valëgjatë dalës (  $R_{nl}$  )

$$R_n = R_{ns} - R_{nl} \quad (12)$$

## 9.6 Shpejtësia e erës

Shpejtësia e erës e matur në lartësi të ndryshme nga toka jep vlera të ndryshme. Gjatë lëvizjes së saj mbi sipërfaqen e tokës lind fërkimi që ka tendencë të ulë shpejtësinë e saj. Për llogaritjen e Evapotranspirimit shpejtësia e erës duhet që të matet në lartësinë 2.0 m nga sipërfaqja e tokës. Kur kjo shpejtësi matet me instrumenta që janë të vendosur mbi këtë lartësi, duhet që të sjellim këtë parametër për vlerat 2.0 m mbi sipërfaqen e tokës, dhe për këtë përdoret formula e mëposhtme :

$$u_2 = u_z \frac{4.87}{\ln(67.8 z - 5.42)} \quad (13)$$

ku:  $u_2$  – shpejtësia në lartësinë 2.0 m nga sipërfaqja e tokës ( m/s )

$u_z$  – shpejtësia e matur në lartësinë z nga sipërfaqja e tokës ( m/s )

z – lartësia e matjes së erës

## 9.7 Evotranspirimi i bimës ( Etc )

Evotranspirimi referues ( Eto ) ndryshon nga evopotranspirimi i bimës ( Etc ) pasi mbulimi i tokës nga bima, karakteristikat e kurorës dhe rezistenca aerodinamike ndryshon nga bari që është marë si referencë për llogaritjen e Eto. Këto ndryshime janë të integruara në koeficientin  $K_c$  . Ky koeficient mund të përcaktohet si një koeficient  $K_c$  ose si shumë i dy koeficientëve të ndryshëm  $K_c = K_{cb} + K_e$  ku:  $K_{cb}$  është koeficienti bazë dhe  $K_e$  është koeficienti avullimit nga toka .

Në këtë punim do ti referohemi vetëm metodës së logaritjes së evapotranspirimit të bimës ( ETC ) me një koeficient .

$$ET_c = K_c ET_{co} \quad (14)$$

ku :  $ET_c$  – evapotranspirimi i bimës ( mm/ditë )

$K_c$  – koefiçenti i bimës ( pa njësi )

$ET_{co}$  – evapotranspirimi referues ( mm/ditë )

Koefiçenti  $K_c$  është një raport i  $ET_c$  me atë të evapotranspirimit referues  $ET_{co}$ . Karakteristikat nga se varet ky koefiçent dhe ndryshimi me  $ET_{co}$  janë :

- **Lartësia e bimës.** Lartësia e bimës ndikon në rezistencën aerodinamike (  $r_a$  ) si dhe në transferimin e avujve nga bima në atmosferë .
- **Albedo** ( reflektimi ) i sipërfaqes së tokës. Albedo ndikohet nga përqindja e mbulimit të tokës nga bimësia dhe nga lagështia e tokës. Albedo në vetvete ndikon në rrezatimin neto të sipërfaqes (  $R_n$  ), që është dhe vurimi kryesor i shkëmbimit të energjisë në procesin e avullimit .
- **Rezistenca e kurorës.** Rrezistenca e bimës në transfrimin e avujve ndikohet nga sipërfaqja e gjetheve ( numri i gojzave ), mosha e gjetheve dhe shkalla e kontrollit të gojzave . Kjo rezistencë ndikon në rezistencën e sipërfaqes (  $r_s$  ) .
- **Avullimi** nga toka, sidomos nga toka e zhveshur nga bimësia .

Siq thamë më sipër koefiçenti i bimës mund të kombinohet në një koeficient të vetëm, ose mund të ndahet në dy faktorë që përshkruajnë veçmas ndryshimet midis avullimit dhe transpirimit. Përzgjedhja e qasjes varet nga qëllimi i llogaritjes, saktësia e kërkuar, të dhënat klimatike të disponueshme dhe hapi kohor me të cilin ekzekutohen llogaritjet. Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes janë .

	<b>Metoda me një Koeficient kulture <math>K_c</math></b>	<b>Metoda me dy Koeficient kulture <math>K_c K_{cb} + K_e</math></b>
<b>Qëllimi i llogaritjes</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- planifikimi dhe projekti i ujitjes</li> <li>- menaxhimi i ujitjes</li> <li>- oraret bazë të ujitjes</li> <li>- Caktimi i ujitjes në kohë reale për aplikime jo të shpeshta të ujit (ujitja sipërfaqësore dhe spërkatëse)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- hulumtimi</li> <li>- Caktimi i ujitjes në kohë reale</li> <li>- caktimin e ujitjes për aplikimin e ujit me frekuencë të lartë (mikro ujitje dhe ujitje e spërkatës automatike)</li> <li>- ujitje plotësuese</li> <li>- studime të hollësishme të bilancit të ujit dhe tokës hidrologjike</li> </ul>
<b>Kohë zgjatja</b>	ditor, 10-ditor, mujor ( të dhënat dhe llogaritjet)	ditor ( të dhënat dhe llogaritjet)
<b>Metoda llogaritëse</b>	grafike makinë llogaritëse kompjuter	kompjuter

*Tabela 13: Kriteret e përgjithshme për qasjen me një ose dy koeficientë ( FAO - 56 )*

### 9.7.1 Mënyra me një koeficientit të vetëm të bimës ( $K_c$ )

Në qasjen e koeficientit të vetëm të bimës, efekti i transpirimit të bimës dhe avullimit të tokës kombinohen në një koeficient të vetëm  $K_c$ . Koeficienti integron ndryshimet në tokën evapotranspiruar dhe shkallën e transpirimit të bimës dhe sipërfaqes së referencës së barit. Ndërsa avullimi i tokës mund të luhetet çdo ditë si rezultat i reshjeve ose ujitjes, koeficienti i vetëm i kulturave shpreh vetëm efektet mesatare të kohës (shumë-ditore) të evapotranspirimit të bimës.

Ndërsa koeficienti i vetëm  $K_c$  mesatarizon avullimin dhe transpirimin e tokës, metoda përdoret për të llogaritur  $E_{Tc}$  për periudha javore ose më të gjata, megjithëse llogaritjet mund të vazhdojnë me një hap ditor. Për një menaxhim tipik të ujitjes, metoda me një koeficient  $K_c$  mesatare është mëse e vlefshme.

### 9.7.2 Mënyra e koeficientit të dyfishtë të kulturave ( $K_{cb} + K_e$ )

Në qasjen e metodës me dy koeficient të bimës, efektet e transpirimit i bimëve dhe avullimit të tokës përcaktohen veçmas. Koeficienti  $K_c$  zëvendësohet nga:


$$K_c = K_{cb} + K_e \quad (15)$$

ku:  $K_{cb}$  - koeficienti bazë i bimës ,

$K_e$  - koeficienti i avullimit të ujit nga toka

### 9.7.3 Kurba e koeficientit të bimës

Minimumet absolute të temperaturës zakonisht ulen nga  $-7^\circ$  deri në  $-8^\circ$  në dimra të ftohtë -  $12^\circ$  deri në  $-13^\circ$ ; në raste të jashtëzakonshëm e në kushte të përshtateshe terreni mund të vrojtohen temperatura të ulëta deri  $-15^\circ \div -17^\circ\text{C}$ . Ditët e akullta vijnë duke u zvogëluar prej veriu në jugë. Mesatarisht vrojtohen 20 – 30 ditë të këtylla.

Periudha me temperature mesatare  $\geq 10^\circ$  zgjat 6 deri në 6 muaj e gjysmë. Fillon midis 15 - 30 marsit dhe vazhdon deri nga mesi i javës së tretë të Nëntorit. Në pjesën e lartë (mbi 400 ÷ 500 m) periudha e përmendur shkurtohet 10 - 20 ditë. Temperatura mesatare  $\geq 7^\circ$  fillon rreth një muaj më parë në pranverë dhe mbaron afërsisht një muaj më vonë në vjeshtë.

Për sa i përket temperaturës mesatare të muajit më të ngrohte nën zona dallohet për temperature mesatare të lartë që në disa pika arrin kufirin 24 ÷ 25°.

Në shpërndarjen e reshjeve vërehet një uniformitet i kënaqshme. Sasia vjetore e reshjeve lëkundet midis 1100 ÷ 1300 mm. Në pika të veçanta sidomos në ekstremet më veriore e me jugore të nën zonës ajo kalon kufirin e përmendur dhe mund të arrijë 1600 ÷ 1800 mm. Stina e dimrit në krahasim me atë të vjeshtës mbizotëron në të gjitha pikat.

Për shkak të ekspozicionit të përgjithshëm perëndimor që ka nën zona dhe të lartësisë jo shumë të madhe mbi det, reshjet janë përgjithësisht në forme shiu. Ato në formë dëbore përbejnë 5 ÷ 15% të të gjithë rasteve me reshje. Akoma me e ulet është përqindja e ditëve me shtresë dëbore. Në pjesën më të madhe të nën zonës (deri në lartësinë 300 ÷ 500 m) ato nuk janë më shumë se 7 ÷ 10 ditë në vit, ndërsa në lartësi më të madhe arrijnë deri në 13 ÷ 17 ditë. Periudha me shtresë dëbore vrojtohet përgjithësisht gjatë Janarit e Shkurtit ndërsa për muajt e tjerë është e rrallë.

Lartësia me e madhe e dëborës zakonisht arrin 10 ÷ 15 cm. Në pika të veçanta deri në 40 cm. Në pjesën e lartë trashësia e shtresës së dëborës (për periudhe kohe shkurtër) mund të arrijë deri në 70 ÷ 80 cm. Numri i ditëve me reshje 21.0 mm gjatë vitit arrin në 95 - 105 dite.

## Nën zona mesdhetare kodrinore juglindore

Përfshin luginën e lumit Drinos dhe në vazhdim atë të Vjosës deri në Kute, luginën e Shushicës dhe pjesën që shtrihet në perëndim të malit të Shpiragut deri në malin e Lungarës. Nën zona paraqet një uniformitet të mirë në pikëpamje të relievit dallime në këtë drejtim ka në luginën e përroit të Bënçës dhe deri diku në atë të përroit të Belicës). Kjo nënonë për karakterin e theksuar luginor me drejtim veriperëndim - juglindje i nënshtrohet në mënyre aktive ndikimit të detit Adriatik dhe me pak atij Jonian. Këtë drejtim ka edhe qarkullimi i erërave përgjatë vitit. Në gjysmën e ftohtë mbizotëron juglindja dhe në gjysmën tjetër veriperëndimi.

Në tërësinë e relievit të nën zonës spikatin dy pjesë të cilat dallohen nga njëra - tjetra, lugina e përroit të Bënçës bashkë me rrjedhjen e sipërme të Shushicës dhe ajo e përroit të Belicës. Këto pjesë përfaqësojnë edhe pjesën më të lartë të saj.

Temperatura mesatare vjetore lëkundet në intervalin  $14 \div 15^\circ$ , kurse në pjesët më të larta  $11 \div 13^\circ$ . Vlerat e temperaturës mesatare të Janarit si muaji më i ftohtë i vitit janë mbi  $5^\circ$ .

Në vartësi të temperaturës mesatare periudha e vegjetacionit (temperatura mesatare  $\geq 10^\circ$ ) mesatarisht fillon në fund të javës së tretë të Marsit, ose nga fillimi i javës së parë të prillit dhe vazhdon deri në fund të Nëntorit.

Minimumet absolute të temperaturës që zakonisht vërehen lëkunden midis intervali  $-3^\circ \div -5^\circ$  për pjesën e ulët dhe  $-5^\circ \div -8^\circ$  për pjesën e lartë. Në dimra të ftohtë arrijnë përkatësisht nga  $-7^\circ \div -11^\circ$  dhe  $-10^\circ \div -15^\circ$ . Periudha me temperature minimale  $\leq 0^\circ$  zgjat  $30 \div 40$  ditë në pjesën e ulët dhe  $45 \div 55$  ditë në pjesën e lartë. Ngricat e fundit sidomos në pjesën e lartë mund të vërehen deri nga fundi i dekadës së parë të muajit prill.

Nën zona dallohet për sasinë e madhe të reshjeve. Në këtë drejtim vërehen ndryshime të mëdha ndërmjet pjesëve të ndryshme të saj. Kështu në pjesën që shtrihet në perëndim të Shpiragut (deri në Sevaster, bien mesatarisht  $1000 \div 1100$  mm reshje, në luginën e Drinosit  $1500 \div 1700$  mm dhe në luginën e Shushicës e të përroit të Bënçës  $2500 \div 2700$  mm në vit. Reshjet kanë intensitet të madh dhe shpesh janë të shoqëruara me stuhi. Numri i ditëve me reshje  $\geq 1.0$  mm lëvizë nga 110 deri në 120 ditë.

Shtresa e dëborës sidomos në pjesën e ulët nuk është një fenomen i zakonshëm. Lartësia e saj më e madhe arrin në rreth  $30 \div 40$  cm, ndërsa ajo e zakonshme është  $10 \div 15$  cm. Në pjesën e lartë trashësia e shtresës së dëborës është më e madhe nga ajo që u përmend. Shtresa e dëborës fillon mesatarisht në javën e parë të Janarit dhe me ndërprerje vërehet deri nga mesi i Shkurtit (pjesa e ulët) e deri në javën e parë të Marsit (pjesa e lartë). Në dimra të ftohtë datat e përmendura s'postohen me  $10 \div 15$  ditë. Nga ana tjetër theksojmë se ka raste që shtresa e dëborës (sidomos për pjesën e ulët) nuk vërehet fare.

### **Nën zona mesdhetare kodrinore jugperëndimore.**

Zë pjesën jugperëndimore të zonës dhe shtrihet përgjatë gjithë bregdetit Jonian. Për shkak të afërsisë me detin i nënshtrohet ndikimit të tij çdo periudhë të vitit. Afërsia me detin përcakton gjithashtu lartësinë e nën zonës nga niveli i detit në pjesën lindore e perëndimore

të saj. Përfaqëson pjesën me të ngrohte të zonës, megjithëse edhe këtu në lartësi të madhe ose pjesë të mbyllura nuk mungojnë temperaturat e ulëta.

Temperatura mesatare vjetore qëndron në intervalin  $13 \div 15^{\circ}$  (vetëm në pjesët më të larta zbret në  $11 \div 12^{\circ}$ ). Mesatarja e temperaturës për Janarin lëkundet nga  $5^{\circ}$  deri në  $7^{\circ}$  ndërsa minimalet absolute të zakonshme janë nga  $-5^{\circ} \div -7^{\circ}$ . Në dimra të ftohtë mund të vrojtohen temperatura të ulëta të cilat mund të variojnë deri në  $-10^{\circ} \div -15^{\circ}$  (në pjesën e lartë).

Reshjet janë të bollshme dhe ruajnë karakteristikat që u përmenden edhe për nën zonën jugore të zonës mesdhetare fushore. Sasia e tyre arrin  $1700 \div 2000$ mm, kurse lartësia e dëborës (në pjesën e lartë) është  $30 \div 40$  cm. Shtresa e dëborës zgjat një periudhe kohe të shkurtër. Vetëm në shpatet veriore e në pjesë të mbrojtura nga dielli dhe era ajo mund të qëndroje për një periudhe më të gjatë kohe.

#### 11.4 Zona mesdhetare para malore

Në këtë zone përfshihet lugina e Drinit, Valbonës, rrjedhja e sipërme e Shkumbinit, pllaja e Korçës dhe Kolonjës, malet e Dangëllisë e Postenanit, si dhe pjesët më të larta të vargmalit Krujë – Dajt - Çermenikë. Pozicioni luginor si dhe lartësia e konsiderueshme mbi det (për një pjesë të zonës) janë ndër faktorët që ndikojnë mbi kushtet klimatike të saj. Duke u bazuar në ndryshimet që vërehen në vlerat e elementeve klimatike dhe në ecurinë e tyre gjatë vitit kjo zonë ndahet në dy pjesë: veriore dhe jugore.

- veriore
- qendrore

#### Nën zona mesdhetare paramalore veriore

Në përbërjen e saj bën pjesë lugina e Drinit edhe Valbonës si dhe pjesët më të larta të vargmalit Krujë – Dajt – Çermenikë, duke kapur kështu pjesën më të madhe të zonës së përmendur. Për vet shtrirjen dhe karakteristikat e relievit ajo përben një njësi më vete. Relievi i ulët në veri të saj dhe lugina e Drinit të Bardhë janë portat kryesore nga depërtojnë erërat lindore e verilindore (në mënyrë të veçante për pjesën veriore të nën zonës). Në pjesën jugore në dimër mbizotërojnë erërat e juglindjes kurse në verë ato të perëndimit.

Regjimi termik i nën zonës përcaktohet kryesisht nga pozicioni i saj luginor. Temperatura mesatare vjetore lëvizë midis  $10 - 11^{\circ}$  dhe në pjesë më të larta deri në  $9^{\circ}$ . Dimri është i ftohte. Ditët e akullta (temperatura minimale  $\leq 0^{\circ}$ ) kapin si numër gjysmën e periudhës së ftohtë ( $80 \div 100$  ditë), kurse ngricat e fundit vrojtohen mesatarisht deri nga fundi i muajit prill e fillimi i javës së parë të majit.

Temperatura mesatare e Janarit deri në lartësinë 500 - 600 metra në përgjithësi ka vlera pozitive ose afër zeros, ndërsa në pjesët mbi lartësinë e përmendur zbret në  $-2^{\circ} \div -3^{\circ}$ .

Minimumet absolute të temperaturës që zakonisht vrojtohen lëvizin ndërmjet:  $-10 \div -12^{\circ}$ , por në dimra të ftohtë e shumë të ftohtë ato arrijnë në  $-18^{\circ} \div -25^{\circ}$  C.

Në rastet e mbizotërimit të frontit të ftohte stacionar temperaturat e ulëta vazhdojnë për disa ditë duke ushtruar kështu një ndikim të rëndësishëm edhe mbi vlerat mesatare mujore apo vjetore të temperaturës.

Periudha e vegjetacionit (temperatura  $\geq 10^{\circ}$ ) kap mesatarisht intervalin prej fundit të javës së dytë dhe fillimit të javës së tretë të prillit deri nga mesi i javës së tretë të tetorit, ndërsa periudha me temperature mesatare  $\geq 7^{\circ}$  zgjat 33 - 37 ditë më shumë se ajo me temperature  $\geq 10^{\circ}$ .

Regjimi termik në këtë nën zonë paraqit një uniformitet të kënaqshëm ndërsa për reshjet një larmi e theksuar. Pjesa lindore e nën zonës merr më pak reshje. Këtu sasia vjetore arrin në 900 - 1000 mm. Në pjesën veriore kjo sasi është 1700-1900 mm dhe në pjesën perëndimore arrin në 2000 mm. Shkaku i kësaj shpërndaje duhet kërkuar në karakteristikat e relievit. Pjesa lindore ngel në hije të maleve që i qëndrojnë si përkrenare gjatë gjithë shtrirjes së saj. Edhe numri i ditëve me reshje shkon duke u zvogëluar prej perëndimit në lindje si dhe prej veriut në jugë. Në këtë nën zonë vrojtohen rreth 100 ditë dhe në pika të veçanta 110 -115 ditë me reshje  $\geq 10$  mm.

Trashësia maksimale e shtresës së dëborës është në vartësi të drejtpërdrejtë të lartësisë mbi det dhe të ekspozicionit të shpateve. Zakonisht ajo lëviz nga 40 - 80 cm, por në pika të veçanta vrojtohen deri në 2 m dëborë (Bulqizë 2m, Pukë, Kurbnesh, Krumë deri 1.5m, et.). Shtresa e dëborës me ndërprerje mesatarisht zgjat 35 - 40 ditë. Në pika të veçanta në kushte të përshtatshme fiziko - gjeografike ajo mund të zgjasë më shumë nga sa u përmend. Periudha me shtresë dëbore kap zakonisht muajt dhjetor-mars ndërsa në prill e nëntor edhe pse ajo vrojtohet është shumë e kufizuar.

## Nën zona mesdhetare paramalore jugor

Përmbledh pllajën e Korçës edhe Kolonjës, malet e Dangëllisë e Postenanit, rrjedhjen e sipërme të Shkumbinit prej Qukësit në Trebinjë si dhe bregun e liqenit të Pogradecit.

Dallimet midis kësaj nën zone dhe asaj veriore janë më të theksuara në elementin e reshjeve. Në pjesën më të madhe të nën zonës shuma vjetore e reshjeve është 650 – 750 mm. Vetëm në dy ekstremet e saj (jugore dhe veriore) ajo arrin dhe në disa pika i kalon të 1000 mm. Numri i ditëve me reshje  $\geq 1.0$  mm lëvizë nga 85 në 95 ditë. Trashësia maksimale e dëborës në shumë pika arrin në 30-50 cm, duke përfaqësuar kështu vetëm 1/3 apo 1/4 e asaj që vrojtohet tek nën zonën veriore (Pukë apo Bulqizë). Numri i ditëve me shtresë dëbore arrin në 25 - 30 ditë. Vetëm pjesa qendrore e nën zonës (fusha e Korçës) i afrohet më shumë në këtë drejtim nën zonës veriore.

Temperatura mesatare vjetore lëvizë midis  $9.5^{\circ}$  -  $10.5^{\circ}$ . Më e ngrohtë paraqitet lugina e Shkumbinit dhe pjesa me jugore e nën zonës. Një gjë e tillë vërehet edhe me temperaturat mesatare të janarit te cilat janë mbi  $0^{\circ}$  dhe lëvizin nga  $0.5^{\circ}$  deri në  $2^{\circ}$ .

Nën zona jugore sidomos pjesa qendrore e saj është ndër pjesët më të ftohta të vendit. Minimumet absolute të temperaturës që mund të vrojtohen çdo vit janë  $-10^{\circ}$  ÷  $-12^{\circ}$ . Në dimra të ftohtë zbresin deri në  $-15^{\circ}$  ÷  $-18^{\circ}$  e ne raste te rralla ato mund te arrijnë vlera  $-25^{\circ}$  ÷  $-26^{\circ}$ .

Numri i ditëve të akullta: (temperatura minimale  $\leq 0^{\circ}$ ) mesatarisht lëviz nga 85 deri në 100 ditë edhe në ndonjë pikë të veçante deri në 110 dite. Në Përrenjas , Pogradec e Leskovik ky numër lëviz ndërmjet 50 ÷ 60 ditë.

Temperatura mesatare e muajit më të nxehtë është  $19^{\circ}$  ÷  $21^{\circ}$  ndërsa amplituda e vlerave ekstreme arrin  $50^{\circ}$  ÷  $60^{\circ}$ (më e theksuar është në Korçe e Bilisht).

Periudha e vegjetacionit (temperatura mesatare  $\geq 10^{\circ}$ ) zgjat afërsisht 6 muaj. Si datë mesatare të fillimit duhet marre mesi i javës së tretë të prillit dhe vazhdon deri nga fundi i javës së tretë të tetorit. Ne kuptimin e periudhës se vegjetacionit duhet të ndryshoje edhe kuptimi mbi periudhën e ngrohtë edhe të ftohtë të vitit sidomos për zonat paramalore e malore. Pra periudha e ngrohtë duhet të përfshijë maj ÷ tetor dhe ajo e ftohtë nëntor ÷ prill.

Periudha me temperaturë mesatare  $\geq 7^\circ$  fillon 20 ditë me herët në pranverë dhe mbaron 20 ditë me vonë në vjeshtë, kundrejt me temperaturës mesatare  $\geq 10^\circ$ .

Drejtimi i erës i nënshtrohet drejtpërdrejte ndikimit të relievit. Përgjithësisht në Pogradec dhe Ersekë mbizotëron drejtimi nga veriu dhe drejtimi nga jugu, në Korçë drejtimi jugperëndimi dhe në Sheqeras drejtimi nga lindja.

## 11.5 Zona mesdhetare malore

Siç është theksuar dhe me sipër në lartësi të mëdha (mbi 1000-1300m) vërehen ndryshime të ndjeshme në regjimin e elementeve klimatike.

Zona klimatike malore përmbledh gjithë vargmalet e vendit tonë. Në përputhje me ndryshimet që vërehen ndërmjet pjesëve të ndryshme zona ndahet në 4 nën zona:

- veriore
- qendrore
- juglindore
- jugperëndimore.

### Nën zona mesdhetare malore veriore

Kjo nën zone përmbledh gjithë malet që shtrihen në të djathtë të rrjedhjes së Valbonës dhe Drinit. Format e ndryshme të relievit, luginat që e përshkojnë si dhe lartësitë pak a shumë uniforme i japin kësaj nën zone një karakteristike të veçante edhe nga ana fiziko - gjeografike.

Para se gjithash duhet të theksojmë se Alpet e Shqipërisë ashtu sikurse shumë zona të tjera malore ngelen akoma të panjohura mirë nga pikëpamja klimatike. Për klimën e tyre gjykojmë nga disa pika vrojtimi lartësia e të cilave rrallë herë i kalon të 1200 ÷ 1300 m si dhe nga ndërtimi i hartave izotermike.

Alpet janë ndër pjesët më të ftohta të vendit tonë ato janë gjithashtu ndër zonat ku bien më shume reshje përgjatë vitit si dhe ku mungesa e lagështirës ndihet me pak.

Kushtet e ngrohtësisë përcaktohen në mase të madhe nga lartësia mbi nivelin e detit.

Temperatura mesatare e janarit si muaji më i ftohtë i vitit në pjesën e ulët të nën zonës (deri në 1100 ÷ 1300 m) përgjithësisht ka vlera rreth  $0^{\circ}$  ose nën zero ( $-2^{\circ}$  ÷  $-3^{\circ}$ ), ndërsa në pjesën e lartë të nën zonës vlerat e saj zbresin në  $-4^{\circ}$  ÷  $-6^{\circ}$  dhe si dhe në pika të veçanta edhe deri në  $-7^{\circ}$  ÷  $-8^{\circ}$ . Temperatura mesatare e korrikut lëviz në intervalin  $15^{\circ}$  ÷  $18^{\circ}$  si dhe në pika të veçanta i kalon të  $20^{\circ}$  (Dragobi  $21^{\circ}$ ). Në disa pjesë të nën zonës të cilat kanë lartësi të madhe temperatura mesatare ka vlera pozitive në jo më shumë se 7 ÷ 8 muaj në vit. Reshjet e bollshme dhe temperaturat e ulëta të kësaj nën zone përbejnë një baze të fortë për qëndrueshmërinë e madhe të shtresës së dëborës.

Temperatura mesatare vjetore“ në pjesën e ulët të nën zonës lëviz midis  $7^{\circ}$  ÷  $11^{\circ}$ , ndërsa në pjesën e lartë të nën zonës  $4^{\circ}$  ÷  $6^{\circ}$ .

Në regjimin termik të nën zonës një rol të rëndësishëm kanë ekstremet absolute të temperaturës e në veçanti ato minimale. Vrojtimet faktike (për 15 ÷ 20 vitet e fundit) tregojnë se minimumet absolute të zakonshëm për pjesën e ulët janë  $-10^{\circ}$  ÷  $-13^{\circ}$  dhe në dimra të ftohtë  $-20^{\circ}$  ÷  $-22^{\circ}$ . Në vartësi të formave të relievit ato mund të jene edhe me të ulëta. Në lartësi të mëdha vlerat e minimumeve mund të zbresin deri në kufijtë nga  $-23^{\circ}$  deri në  $-27^{\circ}$

Për ashpërsinë e dimrit në këtë nën zone mund të gjykohet edhe nga numri i ditëve të akullta gjatë vitit që edhe në pjesët më të ulëta të saj i kalon të 100 ÷ 110 ditët, ndërsa në pjesët e larta arrin në 150-170 ditë.

Periudha e vegetacionit është mjaft e shkurtër në krahasim me zonat e tjera klimatike të vendit. Në pjesën e ulët të nën zonës temperatura mesatare  $\geq 10^{\circ}$  fillon në javën e tretë të prillit ose fillimin e majit dhe mbaron nga mesi i javës së dytë të muajit tetor, ndërsa periudha me temperature mesatare  $\geq 7^{\circ}$  fillon në javën e parë të prillit dhe mbaron në fund të javës së parë të nëntorit.

Nën zona dallohet për sasinë e madhe të reshjeve. Në këtë drejtim Alpet zënë një vend të rëndësishëm midis zonave të Evropës me reshje të shumta. Në saj edhe të pozicionit të tyre ndaj erërave të pasura me lagështirë dhe lartësisë së madhe mbi nivelin e detit, këtu çdo vit bien mesatarisht 2000 - 2500 mm reshje, të përqendruara kryesisht në gjysmën e ftohtë të vitit. Nuk janë të rralla vitet kur sasia e reshjeve vjetore i kalon të 3000 mm dhe në ndonjë pikë i dhe të 4000 mm. Sasia më e madhe e reshjeve bie në shpatet perëndimore të maleve. Në drejtim të lindjes kjo sasi vjen duke u pakësuar. Në lidhje të ngushte me sasinë është numri i ditëve me reshje . Gjatë vitit vrojtohen 110 ÷ 140 ditë me reshje  $\geq 1.0$  mm.



Reshjet e bollshme dhe temperaturat e ulëta krijojnë kushte që shtresa e dëborës të zgjasë në pjesën e ulët nga 60 deri në 100 ditë dhe në pjesën e lartë nga 130 deri në 160 ditë. Në pika të veçanta të nën zonës të cilat kanë lartësi të madhe shtresa e dëborës është e përhershme.

Lartësia maksimale e shtresës së dëborës është në vartësi të formave të relievit. Matjet e kryera në pjesën e ulët kanë treguar se ajo arrin në 1.5 ÷ 2.5 m. Nuk përjashtohet mundësia që të jetë edhe më e madhe. Në pjesën e lartë të nën zonës shtresa e dëborës ka trashësi më të madhe nga ajo që u përmend sikurse dhe në vende të mbrojtura mund të arrijë në 3 ÷ 4 m.

Regjimi i erës është në vartësi të periudhës së vitit dhe formave të relievit. Gjatë periudhës maj ÷ tetor mbizotëron drejtimi nga jugu dhe jugperëndimi, ndërsa gjatë gjysmës së ftohtë erërat fryjnë nga drejtimi i veriut dhe ai lindjes. Si ere karakteristike dhe më e shpeshtë është murrllani i cili mund të jetë ciklonik apo anticiklonik.

## Nën zona mesdhetare malore lindore

Në përbërjen e nën zonës hyjnë malet që ndodhen në jug të luginës së Drinit dhe në veri të luginës së Shkumbinit. Këtu hyjnë gjithashtu malet e Lumes, Korabi e Deshati.

Në të gjithë nën zonën mbizotërojnë erërat që fryjnë nga veriu, verilindja edhe juglindja. Për nga ashpërsia e klimës kjo nën zone është e ngjashme me nën zonën veriore. Edhe këtu temperatura mesatare vjetore për pjesën e ulët (1100 -1300m) qëndron në kufirin 7 ÷ 10° kurse në pjesën e lartë 2° ÷ 6°. Në mënyre të veçante në majat më të larta të pjesës lindore, si p.sh. në Korab, mesatarja vjetore e temperaturës nuk i kalon të 2° ÷ 3°.

Vlerat e temperaturës mesatare dhe atyre absolute së bashku me to edhe nëmuri i ditëve të akullta përcaktojnë karakteristikat e regjimit të ngrohtësisë të nën zonës.

Minimumet absolute të temperaturës lëvizin në intervalin -10° ÷ -15°, në dimra të ftohtë ato zbresin në -18° ÷ -20° dhe në raste të rralla në pika të veçanta si të drejtpërdrejtë edhe të formave të relievit, ato mund të arrijnë deri në -30°.

Në pjesën e ulët të nën zonës ditët e akullta (temperatura minimale  $\leq 0^\circ$ ) arrijnë në 120 ÷ 150 ditë, ndërsa në pjesën e lartë ky numër rritet dhe mund të kapi periudhën prej 180 ÷ 220 ditë. Temperatura mesatare e janarit ka vlera mjaft të ulëta. Në pjesën e ulët ato qëndrojnë në intervalin -2° ÷ -3°, në pjesën e lartë midis -4° ÷ -6° dhe në pikat më të larta arrijnë deri në -8° ÷ -10°.

Në përputhje me sa u përmend për regjimin e ngrohtësisë periudha e vegjetacionit pëson ndryshime të rëndësishme.

Temperatura mesatare  $\geq 10^{\circ}$  vrojtohet nga fundi i prillit ose fillimi i majit dhe zgjat deri nga fundi i javës së tretë të muajit tetor. Rreth një muaj më e gjatë është periudha me temperature mesatare  $\geq 7^{\circ}$ . Amplituda e vlerave ekstreme të temperaturës arrin në  $55 \div 60^{\circ}$ . Kurse temperatura mesatare e gushtit ka vlera midis  $15 \div 18^{\circ}$  (në pjesët më të larta  $10^{\circ} \div 12^{\circ}$ ).

Reshjet janë elementi ku dallimet midis kësaj nën zone e asaj veriore behën me të theksuara. Sasia vjetore e tyre lëviz mesatarisht nga 1300 deri në 1800 mm. Në shpatet perëndimore kjo sasi arrin deri në 2000 mm, ndërsa në ato lindore është nën 1300 mm.

Shtresa e dëborës (për pjesën e ulet) vërehet që në dekadën e tretë të nëntorit dhe vazhdon me ndërprerje deri nga fundi i javës së parë të prillit. Numri i përgjithshëm i ditëve me shtresë dëbore lëviz midis  $60 \div 80$  ditë dhe në pika të veçanta i kalon ditët. Në pjesën e lartë të nën zonës numri i ditëve me shtresë dëbore rritet në mënyre të ndjeshme e në pika të veçanta dëbora formon shtresë të përhershme. Numri i ditëve me reshje  $\geq 1.0$  mm lëviz midis 100 - 125 ditë.

Trashësia maksimale e shtresës së dëborës është më e vogël se në nën zonën veriore. Në bazë të vrojtimeve ajo arrin  $60 \div 80$  cm dhe në raste të rralla deri në 2 m. Në pjesën e lartë të nën zonës në vende të mbrojtura lartësia e shtresës së dëborës i kalon shifrat e përmendura.

## Nën zona mesdhetare malore juglindore

Kjo nën zone përfshin vargmalet që shtrihen midis luginës së Vjosës në jugë dhe luginës së Shkumbinit në veri. E gjithë nën zona përshkohet nga lugina e Devollit dhe Osumit deri në brendësi të saj bile deri në kufirin tonë me Greqinë.

Erërat më të shpeshta janë ato me drejtim juglindore, lindore, jugore dhe veriore. Në periudhën e verës mbizotëron drejtimi veriperëndimi, shpejtësitë më të mëdha u takojnë erërave të ardhura nga lindja dhe perëndimi.

“Dimrat edhe këtu janë të ftohtë kështu që temperaturat e ulëta janë fenomen i zakonshëm, megjithatë kjo nën zonë nuk e ka ashpërsinë e nën zonës lindore.

Temperatura mesatare vjetore e ajrit (deri në 1300 m) lëviz në kufijtë  $7^{\circ} \div 10^{\circ}$ , në lartësi më të madhe  $3^{\circ} \div 6^{\circ}$ , në pika të veçanta janë edhe më të ulëta.

Temperatura mesatare e janarit është  $-1^{\circ} \div -2^{\circ}$  për pjesën e ulet dhe  $-3^{\circ} -4^{\circ}$  për pjesën e lartë . Në pika të veçanta të pjesës së larte ajo mund të zbrësë në  $-5^{\circ} \div -6^{\circ}$ . Minimumet absolute të temperaturës zakonisht arrijnë  $-10^{\circ} \div -13^{\circ}$ , në dimra të ftohtë  $-15^{\circ} \div -18^{\circ}$  dhe në raste të rralla deri  $-22^{\circ} \div -26^{\circ}$  (pjesa e ulet). Në lartësi të madhe dhe në vartësi të formave të relievit temperatura minimale arrin vlera me të ulëta nga ato që u përmenden.

Periudha me temperature  $\geq 7^{\circ}$  fillon mesatarisht nga mesi i muajit prill dhe mbaron nga fundi i tetorit, ndërsa ajo me temperature mesatare  $\geq 10^{\circ}\text{C}$  fillon rreth datës 10 ÷ 13 maj dhe mbaron nga fundi i javës së parë të tetorit.

Ditët e akullta edhe në këtë nën zonë përbejnë një numër të konsiderueshëm. Të tilla ditë vrojtohen duke filluar nga tetori edhe deri në qershor. Në pjesën e ulet ka 110 ÷ 140 ditë të akullta ndërsa në pjesën e lartë ky numër është më i madh dhe mund të arrijë në 150 ÷ 200 ditë.

Temperatura mesatare e gushtit lëviz ndërmjet  $16^{\circ} \div 18^{\circ}$  dhe vetëm në majat më të larta zbret në  $12^{\circ} \div 14^{\circ}$ . Amplituda e vlerave ekstreme arrin  $50^{\circ} \div 60^{\circ}\text{C}$ .

Nën zona juglindore është pjesa malore që merr më pak reshje në vendin tonë. Sasia vjetore e tyre lëviz midis 900 ÷ 1200 mm. Në shpatet perëndimore kjo sasi është më e madhe nga sa u përmend. Numri i ditëve me reshje  $\geq 1.0$  mm luhetet midis 100 ÷ 110 ditë. Në këtë nën zonë vërehet një ulje e sasisë së reshjeve në periudhën e verës megjithëse raporti i sasisë së reshjeve të stinës më të thatë dhe asaj më të lagët është i njëjti me nën zonën lindore apo veriore.

Shtresa e dëborës fillon në javën e parë të dhjetorit dhe vazhdon deri nga mesi i javës së parë të prillit. Numri i ditëve me shtresë dëbore është me i vogël se në nën zonat e tjera. Çdo vit vrojtohen 50 ÷ 60 ditë të këtilla. Në pjesën e larte ky numër është më i madh dhe në pika të veçanta vetëm gjatë 3 ÷ 4 muajve vrojtohet mungesa shtresës së dëborës.

Lartësia maksimale e shtresës së dëborës lëviz midis 30 ÷ 40 cm. Në pika të mbrojtura dhe lartësi të mëdha arrin në 1.5 ÷ 2.0 m.

## Nenzona mesdhetare mal ore jugore

Në përbërjen e kësaj nën zonë hyjnë malet që përfshihen midis luginës së Vjosës dhe bregdetit jonian. Në vetvete nën zona përfaqëson vargmale të veçuara me shtrirje veriperëndim - juglindje të ndarë nga njëri tjetri me lugina të gjera dhe mjaft të zhveshura.

Shtrirja e tyre karakteristike dhe luginat që i ndajnë krijojnë kushte për ndryshime të rëndësishme si midis kësaj nën zonë e nën zonave të tjera, po ashtu brenda përbrenda nën zonës.

Një pjesë i nënshtrohet ndikimit të drejtpërdrejtë të detit Jon, kurse pjesa tjetër për shkak të qarkullimit karakteristik veriperëndim – juglindje dhe ndikimit të dobët të Adriatikut.

Mungesa e të dhënave faktike në mënyre të veçante për këtë nën zonë na detyron që konkluzionet mbi karakteristikat e elementeve klimatike të nxjerrim duke u mbështetur më tepër në hartat izotermike dhe në ato të reshjeve.

Pjesa lindore e nën zonës ( Nemërçke – Dhëmbëlan – Trebeshinë – Shëndelli – Lunxheri – Bureto ) shkak të lartësisë dhe largësisë më të madhe nga deti është më e ftohet së pjesa perëndimore. Në këtë pjesë temperatura mesatare vjetore lëviz nga 6° deri në 10° në vendet më të ulëta deri 12°(lugina e përroit të Zagorisë). Në pjesën perëndimore (Cike, Gribe – Kurvelesh, Mali i Gjëre) vlerat e kësaj temperature lëvizin midis 8 °÷12°.Mesatarja e muajit janar si muaji më i ftohtë i vitit në pjesën lindore është -1° ÷ -2°në pika të veçanta deri -4°, ndërsa në pjesën perëndimore lëviz nga 1°deri në 0°,e në ndonjë pikë deri në -2°.

Minimumet absolute të temperaturës janë me pak të theksuara së në zonat e tjera megjithatë në pjesën lindore ato mund të arrijnë vlera - 15°÷ -22°, ndërsa në pjesën perëndimore -13° ÷ -16°.Në nën zonën jugore ruhen të gjitha karakteristikat mesdhetare në shpërndarjen e reshjeve, por sasia e tyre nga një pjese në tjetrën ka ndryshime të ndjeshme. Pjesa perëndimore merr pothuajse dyfishin e sasisë që merr pjesa lindore. Në pjesën perëndimore bien mesatarisht 2000 ÷ 2500 mm ndërsa në atë lindore 1200 ÷ 1400 mm.

Stina e verës paraqitet më e thatë se në të gjitha zonat e tjera klimatike të vendit. Raporti i sasisë së reshjeve të stinës më të thatë me atë të lagët është mbi: 9 ÷13%, kurse amplituda e reshjeve e shprehur në përqindje të sasisë vjetore është me larta e të gjithë vendit.

Numri i ditëve me reshje është me i vogël se në nën zonat e tjera.

## 12. Tipet e tokave të Shqiperise

### 12.1 Toka dhe llojet e saj

Toka është një bashkim elementesh të ngurta, të lëngshëm dhe të gaztë. Elementet e ngurta minerare përbëhen nga pjesëza me përmasa, forma dhe përbërje kimike të ndryshme. Pjesa organike e tokës është e formuar nga lëndët bimore dhe shtazore, disa të gjalla, të tjerat të shpërbëra. Grumbullimi i lëndëve organike të shpërbëra pjesërisht formon humusin që përfaqëson zakonisht një pjesë të vogël të fazës së ngurtë të tokës sidomos në zonat e thata.

Elementet e lëngshëm apo tretësirat ujore të tokës përmbajnë ujë, lëndë minerare të tretura dhe lëndë organike të shkrishme që mbushin një pjesë ose pjesën më të madhe të hapësirave që ndajnë elementet e ngurta. Ky ujë thithet nga rrënjët e bimëve dhe duhet të zëvendësohet periodikisht nga shirat ose nga ujitja që prodhimi i kulturave të jetë i kënaqshëm. Toka shërben kështu si rezervuar lagështie dhe është e nevojshme të njihet aftësia e këtij rezervuari për të përcaktuar periudhën dhe sasinë e ujit që duhet për ujitjen.

Zbrazëtirat që ndajnë pjesëzat e tokës, të cilat nuk janë të mbushura me ujë janë të zëna nga elemente të gazta. Ky është një përbërës i domosdoshëm i tokës sepse, me përjashtim të bimëve ujore si orizi, sistemi rrënjësor i bimëve ka nevojë për frymëmarrje. Ujitja pra luan një rol të rëndësishëm, sepse mban një baraspeshë ndërmjet ajrit dhe ujit të tokës.

### 12.2 Ndërtimi granulometrik apo tekstura e tokës

Ky ndërtim përcaktohet nga përpjesëtimi i pjesëzave të mëdha, mesatare dhe të imëta që quhen përkatësisht rërë, lym dhe argjilë (deltinë). Kombinimet e ndryshme të këtyre përbërësve, përdoren për të klasifikuar tokat sipas ndërthurjeve të tyre. Rëra, lym dhe deltina përfaqësojnë klasifikimet sipas përmasave të tyre. Rërat kanë diametrin nga  $2 \div 0,05$  mm, lymet nga  $0,05 \div 0,002$  mm dhe deltinat më të vogla se  $0,002$  mm. Këto tri përmasa të pjesëzave në përpjesëtime të ndryshme, përbëjnë llojin e tokës. Ndërthurja e tokës është në lidhje të ngushtë me kapacitetin ujëmbajtës të tokës d.m.th. me rezervën e lagështisë që është në disa pozicione të bimës; ajo përcakton, gjithashtu, në një shkallë të madhe vëllimin e ujit që duhet përdorur, si dhe numrin e ujitjeve. Megjithatë, kur ujitet shpesh është e nevojshme,

që kjo ndërthurje të përcaktohet në vend. Kjo mund të bëhet me anë të përvojës duke përpunuar pak tokë me gishtin tregues dhe gishtin e madh ose duke e shtypur me pëllëmbën e dorës. Përbërja e tokës kur laget dhe përpunohet jep një ide të qartë të përmbajtjes së deltinës. Grimcat e rërës janë të ashpra në prekje. Lymi ose nëndeltina kur është e thatë, në të prekur jep të njëjtën ndjeshmëri si të miellit ose pudrës.

### 12.3 Struktura E Tokës

Mënyra sipas së cilës janë të vendosura grimcat e tokës, afër ose në kontakt me njëra-tjetrën përcaktojnë strukturën e tokës. Në sipërfaqe struktura e tokës është e lidhur lehtë. Ajo kushtëzon përshkrimin dhe qarkullimin e ujit në tokë, ajrimin e saj dhe mundësinë e futjes së rrënjëve në të.

Tokat, në përgjithësi, mund të jenë pa strukturë ose me strukturë. Karakteristika kryesore e tokës pa strukturë është se uji mund të mbushë të gjitha hapësirat ndërmjet pjesëve më të forta të tokës dhe të kufizojë hyrjen në të të ajrit atmosferik, duke bërë që oksigjeni i tokës të konsumohet prej mikroorganizmave. Në këtë mënyrë ndalohet procesi aerobik, i cili nuk krijon mundësi që ushqimi të përvetësohet nga bima mbasi ulen shumë lëndët ushqyese të tretshme në tokë.

Mbas hyrjes së ujit, tokat pa strukturë do të fillojnë të çahen dhe nëpërmjet plasaritjeve do të ketë avullim intensiv. Përmirësimi i regjimit të ushqimit nuk sjell dobi mbasi uji kapilar mbush të gjitha zbrazëtirat ndërmjet tokës së fortë. Lagështia e tokës që ngjitet lart në sipërfaqen e saj nuk lejon ajrin të hyjë në tokë. Në këtë rast bima fillon të ketë nevojë për ushqim, megjithëse në tokë mund të ketë me shumicë si lëndë ushqyese ashtu edhe ujë. Për të gjithë kohën që vazhdon procesi i daljes së lagështisë nëpërmjet gypave kapilarë, lëndët organike, për mungesë oksigjeni nuk thithen prej bimës. Mënyra e mësipërme e daljes së ujit e dëmton bimën duke e çuar atë drejt shkatërrimit, mbasi krijohen kushte asfiksie. Pra vetëm atëherë kur e gjithë vlaga e tokës avullohet, lirohet rruga për hyrjen e ajrit të atmosferës në tokë, e cila tash ka nevojë për ujë. Lind pra e kundërta, kur të gjitha zbrazëtirat e tokës janë të mbushura me ajër, lëndë ushqyese ka me bollëk por bima vuan nga mungesa e ujit.

Cilësia tjetër negative e tokave pa strukturë qëndron në atë që toka nuk është e aftë të furnizojë vazhdimisht me ujë (me lagështi) bimën. Edhe kur toka është e ngopur me ujë

mjafton pak kohë pa reshje dhe me diell që lagështia e tokës të avullohet. Nga eksperimentet e bëra del që në toka pa strukturë mund të qëndrojë vetëm 15% e ujit, ndërsa 85% avullohet pa u përdorur.

Anë tjetër negative e tokave pa strukturë është edhe ai që fryma intensive kapilare e ujit sjell ujë nga pjesa e poshtme e tokës në shtresat e sipërme dhe në bashku me të, edhe elemente të dëmshme, sidomos kripëra, duke ulur në këtë mënyrë prodhimtarinë e tokës.

Cilësi krejt të kundërt ka toka me strukturë, e cila jo vetëm që nuk ka kundërshtime ndërmjet faktorëve të prodhimtarisë, por krijon për bimën kushte të përshtatshme zhvillimi.

Në tokat strukturore ujërat e shirave depërtojnë me lehtësi në hapësirat ndërmjet agregateve strukturore dhe grumbullohen në shtresat e tokës. Në agregatet strukturore uji hyn në gypat kapilarë që formohen midis grimcave të tyre, ndërsa teprica kullon nëpër gypat kapilarë në shtresa të thella.

Në tokat me strukturë, rezerva ujore në gypat kapilarë është e qëndrueshme për një kohë të gjatë.

Mbas shirave, në shtresat e sipërme të tokës me strukturë, uji avullon me shpejtësi duke krijuar përshtypjen se toka është e tharë. Në të vërtetë uji kapilar i agregateve të mëposhtme nuk mund të ngjitet deri në sipërfaqe dhe të avullohet. Ai lëviz nëpër gypat kapilarë të brendshëm të agregateve drejt sipërfaqes për të kaluar në agregatin tjetër të mësipërm, por hapësirat midis agregateve janë më të gjera nga ato të gypave kapilarë, prandaj lëvizja kapilare e ujit ndërpritet. Uji i tepërt pas pushimit të shirave ose ujitjes kullon dhe ajri depërton në hapësirat midis agregateve. Në këtë mënyrë toka furnizohet me oksigjenin e nevojshëm për frymëmarrjen e mikroorganizmave si dhe për oksidimin e lidhjeve minerare, të cilat mund të shfrytëzohen nga bimët. Si rrjedhim në tokat strukturore uji dhe ajri nuk janë në antagonizëm, por në harmoni të plotë dhe bimët furnizohen vazhdimisht e në sasi të nevojshme me ujë dhe me lëndë ushqyese.

Struktura e tokës ndryshon vazhdimisht për shkak të mjaft faktorëve fizikë, kimikë e biologjikë, sikurse janë: veprimi mekanik i rrënjëve të bimëve, ndryshimet atmosferike dhe mpiksësit (koagulentët) e disa joneve (gëlqere, acid-hekuri etj.) Ndryshimet e periudhave të shirave, favorizojnë ripërtëritjen e tokës dhe të strukturës së saj. Por të mbjellësh një tokë kur përmbajtja e ujit është shumë e lartë e degrado atë dhe ndikon në prishjen e strukturës së saj. Një grumbullim i tepërt i kripës së sodës, që ka efekt të alkalizojë tokën, e prish

strukturën, duke thyer ose duke shpërndarë përbërësit deltinorë; nga kjo rrjedh një ulje e përqindjes së infiltrimeve dhe ndodh që toka bëhet pothuajse e papërshkueshme. Edhe uji i shiut mund të veprojë si shkatërrues i strukturës së tokës, për shkak të veprimit të tij mekanik.

Qëndrueshmëria e madhe ose e vogël e grimcave, ndaj veprimit të agregateve shkatërruese, përbën elementin që tregon gradën e qëndrueshmërisë së strukturës. Për matjen e gradës së qëndrueshmërisë (stabilitetit) përdoret matja e qëndrueshmërisë së grimcave të zhytura në ujë për një periudhë kohe. Treguesi stabilitetit të strukturës gjendet si më poshtë:

$$I_s = \frac{A - a}{A} \times 100 \quad (19)$$

ku:  $I_s$  = treguesi i stabilitetit;

$A$  = e gjithë deltina që gjendet në agregat;

$a$  = deltina e shpërndarë në ujë në një kohë të caktuar,

## 12.4 Poroziteti

Si rezultat i krijimit të ndërthurjes të agregateve struktural, në tokë, krijohet një sistem me hapësira të zbrazëta ose pore, karakteristikat e të cilave, si dhe sasia e tyre, vlejné për të përcaktuar porozitetin e tokës.

Nga përmasat e poreve dallohen edhe llojet e porozitetit:

Tokat ranore janë të mbushura me makropore, punohen më mirë dhe kanë aftësi të dobët ujëmbajtëse; tokat deltinore që janë të pasura me mikropore punohen me vështirësi, por kanë aftësi të madhe ujëmbajtëse.

Poroziteti mund të shprehet si raport  $P = P = \left(\frac{V_e}{V}\right) 100$  ku

$V_e$  = vëllimi i hapësirave të zbrazëta që përfshin pjesën e lëngshme dhe të gaztë dhe,  $V$  = vëllimi i përgjithshëm i tokës që përfshin vëllimin e pjesës së ngurtë, të lëngshme e të gaztë.



## 12.5 Dendësia

Për tokën dallohen dy lloje dendësish:

- Dendësinë faktike ose peshën specifike të tokës, që është shuma e peshës së secilës grimcë, nga të cilat formohet toka, dhe që peshon nga 1,7 ÷ 2,5 në toka organike në 2,5 ÷ 2,85 g/cm<sup>2</sup> në toka minerare, sipas peshës specifike të mineraleve që e përbëjnë.
- Dendësia e dukshme ose peshën e skeletit (apo vëllimit) që jepet nga pesha e një vëllimi njësor të tokës që përfshin brenda edhe hapësirat e zbrazëta që gjenden në tokë. Vlefata minimale e kësaj dendësie ndryshon nga 0,8 deri 0,9 për tokat humusore dhe 1,5-1,7 për tokat minerare, mbasi si rezultat i zvogëlimit të përqindjes së substancave organike, rritet: vlera e peshës së skeletit, grimcat minerare janë më të rënda dhe poroziteti i tokës bëhet më i vogël. Duke njohur dendësinë e vërtetë të tokës (ose peshën specifike) ( $P_{sp}$ ) dhe dendësinë e dukshme (ose peshën vëllimore) të tokës ( $P_{sk}$ ), mund të përcaktohet poroziteti i përgjithshëm me anën e shprehjes:

$$P = \frac{P_{sp} - P_{sk}}{P_{sp}} \times 100 \quad (20)$$

ku :  $P$  = poroziteti i përgjithshëm në përqindje të vëllimit të përgjithshëm të tokës.

$P_{sp}$  = dendësia e vërtetë ose pesha specifike e tokës.

$P_{sk}$  = dendësia e dukshme ose pesha vëllimore e tokës.

## 12.6 Përshkueshmëria dhe shpejtësia e filtrimeve

Përshkueshmëria është cilësia e tokës, e cila lejon të kalohet nga uji. Masat e saj janë: mm/orë, cm/orë ose m/orë dhe quhen shpejtësia e filtrimit. Kjo cilësi që ka toka është kryesisht efekt i porozitetit të saj. Uji ndërmjet makroporeve lëviz me shpejtësi më të madhe sesa në mikroporet; kështu shpjegohet që në tokat ranore dhe ato me strukturë të mirë përshkueshmëria është më e madhe sesa në tokat deltinore ose në ato me strukturë jo të mirë.

Të gjithë faktorët që ndërhyjnë në strukturë ushtrojnë një ndikim drejtpërsëdrejti mbi përshkueshmërinë e tokës. Ndikimi në strukturë, përveç faktorëve të tjerë, ndodh edhe nga

natyra dhe sasia e joneve, pra nga elementet që marrin pjesë drejtpërsëdrejti në aktivitetin-bazë hidrodinamik, kimik dhe biologjik të tokës.

Përshkueshmëria merr një rëndësi të madhe në studimin e drenimeve në digat e dheut, në kanalet ujitëse, argjinaturave mbrojtëse etj.

Për qëllime drenimi është e rëndësishme të njihet lëvizja e ujit brenda masës së dheut (tokës) të ngopur deri në thellësinë që do të jetë e nevojshme.

Për matjen e tij përdoren metoda të ndryshme.

Sipas literaturës përshkueshmëria klasifikohet në këtë mënyrë:

Shumë e ngadaltë	$K < 0,1 \text{ cm/orë}$
Pak e ngadaltë	$K = 0,1 \div 0,5 \text{ cm/orë}$
E ngadaltë	$K = 0,5 \div 2,0 \text{ cm/orë}$
Pak e ngritur	$K = 2,0 \div 6,5 \text{ cm/orë}$
Mesatarisht e ngritur	$K = 0,6 \div 12,5 \text{ cm/orë}$
E ngritur	$K = 12,5 \div 25,0 \text{ cm/orë}$
Shumë e ngritur	$K = 25 \text{ cm/orë}$

Tokat me vleftë  $K < 10^{-6} \text{ m/sek}$  ose  $V_f < 0,5 \text{ cm/orë}$ , mund të quhen gati të pa filtrueshme dhe duhet të ujiten mbasi të jetë përmirësuar struktura e tyre.

Tokat me vlefta  $10^{-6} < K < 5 \times 10^{-6} \text{ m/sek}$ , ose  $0,5 < V_f < 1,5 \text{ cm/orë}$  janë pak të përshkueshme dhe duhet të ujiten me shumë kujdes.

Tokat me vlefta  $5 \times 10^{-6} < K < 5 \times 10^{-5} \text{ m/sek}$ , ose  $1,5 < V_f < 7,5 \text{ cm/orë}$ , janë me përshkueshmëri të ngadaltë deri mesatarisht të ngritura dhe mund të ujiten me rrjedhje të lirë ose me filtrim nga hullia.

Tokat me vlefta  $K > 5 \times 10^{-5} \text{ m/sek}$  ose  $V_f > 7,5 \text{ cm/orë}$  janë shumë të përshkueshme dhe duhet të ujiten në formë shiu.

## 12.7 Magazinimi i ujit në tokë

Toka është një masë poroze e përbërë nga pjesëza me madhësi të ndryshme dhe të ndara nga hapësira të zbrazëta, që përfaqësojnë në pjesën më të mirë të tokave 40-60% të vëllimit të tyre. Uji depozitohet në këto hapësira dhe përdoret nga bimët, por në vendet me reshje të dobëta toka duhet të furnizohet me ujë nëpërmjet ujitjes.

## 12.8 Ngopja

Gjatë dhe fill mbas një ujitjeje të sipërfaqes, shtresa sipërfaqësore është gati e ngopur. Të gjitha hapësirat e zbrazëta janë pothuajse të ngopura me ujë. Një tokë e ngopur përmban pak ajër dhe meqë bimët, me përjashtim të orizit, kanë nevojë për ajër ashtu si për ujin, duhet për një kohë të arsyeshme të largohet një pjesë e ujit nga hapësira e zbrazët që të mos dëmtohet kultura. Në qoftë se një tokë është e drenuar mirë, një pjesë e ujit qarkullon nga lart-poshtë nën veprimin e peshës dhe në njëfarë mase për kapilaritet. Uji që qarkullon nga lart-poshtë quhet uji i gravitetit ose uji i lirë.

## 12.9 Klasifikimi i tokave

Shqipëria gjendet në Evropën juglindore, dhe në pjesën perëndimore të gadishullit Ballkanik ajo shtrihet midis koordinatave gjeografike 39 gradë e 38' dhe 42 gradë e 39' te gjerësisë veriore dhe 19 gradë e 16' te gjerësisë lindore, në largësi pothuajse të barabartë nga Ekuatori dhe Poli i Veriut. Shqipëria ka një sipërfaqe totale prej 28,748 km katrorë, por vetëm 16.2 % janë nën 100m mbi nivelin e detit.

Relievi i Shqipërisë është kryesisht kodrinor-malor. Vargmalet e para alpine u formuan nga mbarimi i jurasikut, ndërsa gjatë erës kenozoike u shpejtua procesi malformues në tërësinë e Albanideve, që tani përbëjnë tokën e nëntokën e Shqipërisë. Lartësia mesatare e relievit është 708 metra, ose 2 herë më e lartë se mesatarja e Evropës.

Fushat zëne kryesisht pjesën perëndimore, përgjatë bregdetit Adriatik, por ka edhe në pjesë të tjera të vendit. Fushat më të larta janë ato të pellgut të Korçës, mbi 800 metra mbi nivelin e detit. Fushat gjenden kryesisht përgjatë lumenjve kryesore si: Vjosë, Devoll, Osum,

Shkumbin, Erzen, Mat e Drin, ku gjenden, gjithashtu, edhe tokat bujqësore e qendra të mëdha banimi, si dhe përkohën nga rrugë të rëndësishme lidhjesh.

Për shkak të ndryshimeve në klimë, bimësisë natyrore, lartësisë, pjerrësisë si dhe shkëmbinjtë bazë, lloji tokave është shumë e ndryshme.

Si mbas institutit të tokave ato ndahen në katër breza. Kushti kryesor për ndarjen e brezave janë lartësia mbi nivelin e detit dhe bimësia.

Nr	Brezi	Tipi	Shpjegimi	%	Siperfaqja x 1.000 Ha
<b>Tokat Zonale</b>					
1	Tokat Livadhore malore	LM	Tokat Livadhore malore	0.5	3.2
2	Tokat Murrme Pyjore	MP	Toka të Murrme Pyjore Malore	3.0	20.2
		LMP	Toka të Murrme Pyjore Livadhore	0.6	3.4
3	Tokat e Kafenjta	KM	Tokat e Kafenjta Malore	17.7	121.3
		KL	Tokat e Kafenjta Livadhore	5.4	37.0
		LK	Tokat Livadhore e Kafenjta	7.5	51.3
4	Tokat e Hinjta Kafe	HK	Tokat Hinjta Kafe	25.7	176.2
		HKL	Tokat e Hinjta Kafe Livadhore	6.4	50.7
		LHK	Tokat Livadhore të Hinjta Kafe	18.5	127.1
<b>Tokat Azonale</b>					
1	Tokat Aluvionale	AL	Toka Zallishtore	11.8	80.9
2	Tokat Aluvionale Detare	LT	Moçalore	1.4	20.2
		Lkr	Ranore e dunave të vjetra	1.4	3.4
3	Ranore të pazhvilluara	Pm	Toka të pazhvilluara	0.1	0.4
4	Tokat Ranore Detare	PL	Toka të pazhvilluara		0.2
<b>Shuma Totale</b>				<b>100</b>	<b>691.6</b>

*Tabela 17: Tabela e sipërfaqeve dhe llojit të tokave në shqipëri  
(Pandi Zdruli dhe Sherif Lushaj)*

Ndarja e tokave:

1. Brezi tokave Livadhore malore në lartësinë 1600 ÷ 2700 mbi nivelin e deti.
2. Brezi bregdetar Pishore në lartësinë 1000 ÷ 1600 mbi nivelin e deti.
3. Brezi pyjor me Lisa në lartësinë 600 ÷ 100 mbi nivelin e deti.
4. Brezi shkurreve mesdhetare në lartësinë 0 ÷ 600 mbi nivelin e deti.

Brezat e mësipërme tregojnë shpërndarjen e brezave duke ndjekur vazhdueshmërinë si mbas lartësisë dhe bimësisë. Këto toka quhen toka zonale. Karakteristika kryesore e tyre është që formacioni bazë i tyre është formuar në bazë të kushteve biologjike, gjeologjike, topografike, dhe klimatike gjithë ashtu dhe lartësisë. Këto toka nuk ndërthuren me njëra tjetrën.

Atëherë kur formacioni tokës nuk është i lidhur me bimësinë dhe lartësinë mbi nivelin e detit kemi toka azonale siç janë: aluviale, torfe, të kripura dhe toka të pazhvilluara. Këto formacione mund të gjejmë në të gjithë brezat e ndarjes së tokës.


Mënyra e ndarjes së brezave të tokës dhe inventarizimi i tyre është i ndryshëm nga mënyrat në nivel ndërkombëtar. Kjo vjen dhe si pasojë e sipërfaqes së vendit dhe veçanërisht shtrirjes së tokës bujqësore. Kjo mënyre ka shërbyer për të bere kategorizimin e tokës gjithashtu mënyrën plehërimit dhe bonifikimit të tokës.

Sidoqoftë ky sistem nuk është ndërthur me sistemet bashkëkohor siç janë ai Amerikan “Taxonomy” (1998) dhe sistemi i FAO – UNESCO Legjenda e Hartës se Tokës së Botes (1998).

N r	Sistemi Shqiptar	Tipi	Sistemi Amerikan Taxonomy
<b>TOKAT ZONALE</b>			
1	Tokat Livadhore malore	LM	Dystrocryepts
2 3	Toka të Murrme Pyjore Malore Toka të Murrme Pyjore Livadhore	MP LMP	Dystrocryepts, Eutrocryepts Hapludolls, Haplustepts
4	Tokat e Kafenjta Malore	KM	Haplustepts, Haplustepts,H aploxererts, Rhodustalfs Haplusterts
5 6	Tokat e Kafenjta Livadhore Tokat Livadhore e Kafenjta	KL LK	Haplustolls, Calciustolls Hapludolls, Argiudolls
7 8 9	Tokat Hinjta Kafe Tokat e Hinjta Kafe Livadhore Tokat Livadhore të Hinjta Kafe	HK HKL LHK	Haploxeralfs, Haploxerepts, Rhodoxeralfs Haploxeralfs, Haploxerepts, Calcixerolls Haploxererts, Halaquepts, Argiaquolls
<b>TOKAT AZONALE</b>			
1	Toka Zallishtore	AL	Ustifluvents, Xerofluvents Haplustepts, Haploxerepts Haplustolls, Haplustalfs
2 3	Moçalore Ranore e dunave të vjetra	LT Lkr	Medihemists, Medisaprists Calciustolls, Endoaquerts Halaquepts
4	Ranore të pazhvilluara	Pm/PL	Udorhents, Xerorthents Ustorhents, Xeropsamments, Ustipsamments

**Tabela 18:** Klasifikim i tokave si mbas US Taxonomy ( Pandi Zdruli dhe Sherif Lushaj )

Mbi bazën e këtyre të dhënave është ndërtuar dhe harta e tokave të Shqipërisë .



*Figura 6: Harta e tokave të Shqipërisë*

### 13. Harta e shtresës mesatare vjetore të reshjeve.

Në bazë të të dhënave ditore marrë nga projekti Projekti NASA Langley Research Center (POWER).

Në vijim të llogaritjeve është përcaktuar shiu efektiv sipas metodës së Numrit të kurbës së rrjedhjes (SCS), për çdo ditë të vitit.

Proçedura vazhdon duke përcaktuar mesataret mujore përkatëse për të gjitha vitet që kemi në dispozicion .

Nr.	Viti	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Shuma
1	1981	37.65	45.46	22.27	19.17	24.05	1.51	0.00	6.04	26.37	38.03	41.21	71.80	<b>333.56</b>
2	1982	21.92	32.45	49.51	34.74	22.29	1.35	0.00	12.35	14.47	48.33	47.81	57.81	<b>343.02</b>
3	1983	18.47	40.13	24.56	13.09	13.93	22.68	8.11	9.54	16.40	21.13	49.76	52.07	<b>289.87</b>
4	1984	50.99	65.42	40.39	33.04	15.57	0.00	0.00	7.69	22.66	10.32	35.44	26.54	<b>308.05</b>
5	1985	63.35	21.91	61.02	21.18	9.84	0.00	0.00	3.25	4.32	24.42	67.93	27.02	<b>304.24</b>
6	1986	60.82	64.24	33.91	16.85	20.39	13.49	7.37	2.50	15.03	37.90	21.49	36.20	<b>330.18</b>
7	1987	59.95	35.34	45.26	21.44	30.80	7.74	0.00	4.48	4.90	32.69	65.13	32.13	<b>339.85</b>
8	1988	37.64	40.97	32.40	22.07	2.64	5.22	2.08	3.06	11.64	21.24	45.21	35.29	<b>259.45</b>
9	1989	0.80	18.66	16.98	24.04	14.43	12.03	12.39	6.57	11.63	26.22	38.39	28.87	<b>211.00</b>
10	1990	6.20	13.29	2.89	33.85	17.42	1.20	1.66	4.32	3.98	27.55	56.73	77.56	<b>246.64</b>
11	1991	14.33	38.06	24.97	49.28	31.95	4.55	13.98	6.21	10.84	20.72	45.48	23.04	<b>283.40</b>
12	1992	9.33	5.34	32.34	34.46	14.32	11.95	3.88	0.00	12.21	23.02	21.52	36.28	<b>204.65</b>
13	1993	15.65	26.48	32.85	16.37	15.53	3.52	0.00	0.00	9.51	10.03	65.82	40.02	<b>235.78</b>
14	1994	45.05	42.11	9.60	21.17	10.59	5.22	1.02	9.05	8.33	44.14	38.67	39.47	<b>274.42</b>
15	1995	51.61	19.06	42.80	17.87	9.39	1.78	10.43	28.05	24.95	5.73	51.69	58.67	<b>322.02</b>
16	1996	37.10	56.97	46.49	29.21	14.11	4.15	3.98	12.60	41.82	35.19	40.62	54.38	<b>376.62</b>
17	1997	22.62	15.72	19.82	39.17	2.38	7.33	6.87	8.24	8.93	37.39	36.18	66.63	<b>271.29</b>
18	1998	29.37	20.02	15.29	11.73	18.33	3.63	0.00	4.31	33.78	32.85	51.45	42.94	<b>263.71</b>
19	1999	28.83	53.58	40.07	29.90	9.35	2.82	3.37	6.89	22.26	21.23	50.24	56.02	<b>324.56</b>
20	2000	13.30	38.69	9.49	10.71	7.97	8.29	2.25	1.26	8.06	44.68	45.76	33.54	<b>224.01</b>
21	2001	38.25	22.11	20.19	42.33	13.28	2.55	4.16	1.33	23.60	10.51	41.65	57.06	<b>277.02</b>
22	2002	28.15	10.44	22.57	35.03	18.11	4.80	19.46	16.10	50.75	32.18	29.08	74.28	<b>340.96</b>



